



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Nr. 311/____ Prot.

Tiranë, më 29/ 6/2016

V E N D I M

Nr. 71, Datë 29/ 06/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KUKËS "MBI PROCEDURËN E PRANIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE EVIDENTIMIN E TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, për procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin e trajtimit ligjor të mbivendosjeve*”, të ushtruar në ZVRPP Kukës për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, për procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin e trajtimit ligjor të mbivendosjeve*”, të ushtruar në ZVRPP Kukës, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje 1: ZVRPP Kukës në zk 1726 fshati Gjeggjan nga auditimi për 47 pasuri me sipërfaqe 33 911 m², sipas AMTP-ve të llojit arë dhe pemëtore dhe sipërfaqe 63 794 m² sipas LN PIII, pra të rezultuara tepër +29 883 m² tokë bujqësore, për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN PIII, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër, ka lëshuar certifikata për 47 pasuri me sipërfaqe tepër + 29 883 m², prej të cilave: 1 pasuri me sipërfaqe tepër +367 m² ne vitin 2014 dhe 46 pasuri me sipërfaqe tepër +29 516 m² para viteve 2013; veprime këto të kryera nga personat përcaktuar në tabelë (H.K. v.2000-2002 për 3 pasuri me sipërfaqe tepër +1238 m²; z. R. T. v.2003-2006 për 27 pasuri me sipërfaqe tepër +20647 m²; E. N. për v. 2004-2005 për 9 pasuri me sipërfaqe tepër +4906 m²; G. K. v. 2006 për 1 pasuri me sipërfaqe tepër +300 m²; E. D. v.2006-2008 për 3 pasuri me sipërfaqe tepër +2627 m²; S. O.v. 2009-2014 për 2 pasuri me sipërfaqe + 492 m² dhe Gj.S. v. 2006 për 1 pasuri me sipërfaqe tepër + 84 m²), në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “**LËSHIM CERTIFIKATA MBI NORMË AMTP TOKE ARE DHE PEMETORE ZK.1726 GJEGJAN ZVRPP KUKES**” (Trajtuar hollësisht në faqet 7-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 1: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 47 pasuri me sipërfaqe 33 911 m² sipas AMTP-ve të llojit arë dhe pemëtore dhe sipërfaqe 63 794 m² sipas LN PIII, pra të rezultuara tepër +29 883 m² regjistruar dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie të cilat nuk janë tjetërsuar, mbetur gjendje tek mbajtësi i parë, deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” si dhe deri kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër, pasqyruar në tabelën pasqyruar në tabelën emërtuar “**LËSHIM CERTIFIKATA MBI NORMË AMTP TOKE ARE DHE PEMETORE ZK. 1726 GJEGJAN ZVRPP KUKES**”.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 2: ZVRPP Kukës në zk 1726 fshati Gjeggjan sipas listave të trojeve 001, për 73 raste k/familjar në 122 pasuri truall me 48 416 m² ka çelur KPP me sipërfaqe tepër +26 506 m² ka lëshuar certifikata me sipërfaqe tepër dhe pa titull pronësie për 22 pasuri me sipërfaqe tepër + 5770 m² ndare: 15 pasuri me 3976 m² para v. 2013, viti 2014 për 1 pasuri me 24 m² dhe 6 pasuri me 1770 m² ne vitin 2015, pa veçuar, e regjistruar “shtet” sipërfaqen tepër; si dhe nuk janë kryer veprime në KPP për 56 KF me 100 pasuri me sipërfaqe tepër +20736 m², veprime këto të kryera nga znj.Sh. C. për 4 pasuri me 1430 m² v.2015, z. R. T., për 2 pasuri me 180 m², para v.2013, z. S. O.10 pasuri me 2110 m², ndarë 9 pasuri me 2086 m² para v.2013 dhe 1 pasuri me 24 m² për v.2014; z. H. K., 2 pasuri me 315 m², para v.2013; z. E. D. 1 pasuri me 195 m², para v.2013; z. A.B., 1 pasuri me 1200 m², para v.2013; z. G. I., 1 pasuri me 180 m² v.2015 dhe znj. B. D. 1 pasuri me 160 m² v.2015; në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, si dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, datë 29.6.1978 ”Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave” ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²...” pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata

dhe kryer transaksione në KPP zk. 1726 Gjegjan Kukës” (*Trajtuar hollësisht në faqet 7-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 2: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60,74 për 73 raste k/familjar në 122 pasuri truall me 48 416 m² me KPP me sipërfaqe tepër +26 506 m² ndarë: për 22 pasuri me sipërfaqe tepër + 5770 m² lëshuar certifikatat dhe për 56 KF me 100 pasuri me sipërfaqe tepër +20736 m² pa veprime në KPP, deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, deri në shfuqizimin certifikatave të lëshuara dhe veçimin e regjistrimin shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim, pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 1726 Gjegjan Kukës”.

Rekomandim 3: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të mos kryhet asnjë veprim juridik apo transaksion mbi pasuritë bujqësore, pa kryer më parë rakordimet e përputhshmërisë ndërmjet sipërfaqeve sipas titullit të pronësisë AMTP, me sipërfaqen në fakt sipas matjeve të Printim III,(LN) dhe duke konfirmuar verifikimin e titullit të pronësisë në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 3: ZVRPP Kukës në zk 1328 fshati Bushat për 54 pasuri me sipërfaqe 46 322 m² sipas AMTP të llojit arë dhe sipërfaqe 71 599 m² sipas LN PIII pra të rezultuara tepër +29764 m² tokë bujqësore, për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN PIII, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër, ka lëshuar certifikata për 44 pasuri me sipërfaqe tepër + 23 358 m², në periudhën para viteve 2013 përkatësisht (Z.P. për 6 pasuri me sipërfaqe tepër +2222 m²; R. T. për 16 pasuri me sipërfaqe tepër +12940 m²; H.K. për 11 pasuri me sipërfaqe tepër + 7432 m²; S. O. për 4 pasuri me sipërfaqe tepër +1265 m²; E. N. për 4 pasuri me sipërfaqe tepër 1394 m²; L.Gj. për 5 pasuri me sipërfaqe tepër +1616 m²; E.D. për 2 pasuri me sipërfaqe tepër +1242 m²; S. D. për 1 pasuri me sipërfaqe tepër 165 m²; G.I. për 1 pasuri me sipërfaqe tepër +245 m²; A. B. për 5 pasuri me sipërfaqe tepër 763 m² dhe paidentifikuar për 1 pasuri me sipërfaqe tepër +280 m²);

Gjithashtu janë regjistruar kontrata shitje 7 pasuri me sipërfaqe tepër +1 919 m² (AMTP 4 904 m² - 6 823 m² LN); duke mos bërë bilancin AMTP-LN, mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqet e tepërta me përfitime të jashtëligjshme nga personat dhe duke shkaktuar buxhetit të shtetit dem ekonomik në vlerën 426,309 lekë nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie veprime këto të kryera nga personat (S.O. për 477 m² vlera 197,846 leke; E D. për 132 m² në vlerën 40,524 lekë; L.G. për 400 m² me vlerë 129,320 lekë; A. B. për 432 m² me vlerë 36,683 lekë; H. K. për 467 m² me vlerë 21,945 lekë) sipas tabelës “Tokë bujqësore me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione e pa veçuar “Shtet” ZK 1328, Bushat ZVRPP Kukës” dhe në tabelën emërtuar “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie”, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“ dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “Tokë bujqësore me sipërfaqe mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione e pa veçuar “Shtet” sipërfaqen tepër ZK 1328, Bushat ZVRPP Kukës” (*Trajtuar hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 4: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 54 pasuri me sipërfaqe 46 322 m² sipas AMTP të llojit arë dhe sipërfaqe 71 599 m² sipas LN PIII pra të rezultuara tepër +29764 m² tokë bujqësore, ndarë: për 44 pasuri me sipërfaqe tepër +23358 m², të regjistruar dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie dhe pa tjetërsuar, deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN, zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për

Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” dhe shfuqizimin e certifikatave, kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër, ndërsa për 7 pasuri të shitura me sipërfaqe tepër +1 919 m² shitur deri në arkëtimin e vlerës 426,309 lekë demit ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi të cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie z. 1328 Bushat” dhe ”Tokë bujqësore me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione e pa veçuar “Shtet” ZK 1328, Bushat ZVRPP Kukës”.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 4: ZVRPP Kukës në zk 1328 fshati Bushat sipas listave të trojeve 001, për 100 raste k/familjar në 132 pasuri *truall* me sipërfaqe 59 885 m² ka çelur KPP me sipërfaqe tepër +29 885 m² ka lëshuar certifikata me sipërfaqe tepër dhe pa titull pronësie për 18 pasuri me sipërfaqe tepër +4970 m² ndare: 15 pasuri me 3768 m² para v.2013, viti 2013 në 2 pasuri 615 m² viti 2014 në 2 pasuri me 455 m² dhe 1 pasuri me 140 m² në vitin 2015, pa veçuar, e regjistruar “shtet” sipërfaqen tepër, janë shitur 2 pasuri me 220 m² (ref 28, datë 12.11.06 E.D., A.B.) si dhe nuk janë kryer veprime në KPP për 99 pasuri me 43 650 m² dhe sip tepër + 22950 m², veprime këto të kryera nga z. H. K., për 4 pasuri me 845 m², para v.2013; z. R. T. për 1 pasuri me 130 m², para v.2013; znj. B. D. për 2 pasuri me 210 m² v.2014-2015; z. E D. për 3 pasuri me 990 m² ndarë; 2 pasuri me 865 m² para v.2013 dhe 1 pasuri me 125 m² v.2013; z. S. O. për 3 pasuri me 1185 m², ndarë 1 pasuri me 310 m² dhe 2 pasuri me 875 m² v.2013-2014; z.A. Bi. për 4 pasuri me 1460 m², para v.2013 dhe znj. Gj. S. për 1 pasuri me 150 m², para v.2013; veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, datë 29.6.1978” Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave” ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²...” pasqyruar në tabelën emërtuar “**Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 1328 Bushat Kukës**” (Trajtuar hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 5: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 100 raste k/familjar në 132 pasuri *truall* me sipërfaqe 59 885 m² ka çelur KPP me sipërfaqe tepër +29 885 m² ndarë: për 18 pasuri me sipërfaqe tepër + 4970 m² dhe për 99 pasuri me 43 650 m² me sipërfaqe tepër + 22950 m² pa veprime në KPP, deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, deri në shfuqizimin certifikatave të lëshuara dhe veçimin e regjistrimin shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 1328 Bushat Kukës**”.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 5: ZVRPP Kukës në zk 2039 fshati Kalimash për 87 pasuri me sipërfaqe 192 099 m² sipas AMTP të llojit arë dhe 368 154 m² sipas LN PIII pra të rezultuara tepër +176 055 m² tokë bujqësore, për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN PIII, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër a. ka lëshuar certifikata për 38 pasuri me sipërfaqe tepër + 90 076 m², përkatësisht: nga punonjësit 1. R.T. për 25 pasuri me sipërfaqe 67 493 m² AMTP me 135 447 m² LN me sipërfaqe tepër + 67 954 m² nga të cilat: (2 pasuri me 6000 m² AMTP me 23204 m² LN sipërfaqe tepër + 17204 m² në v. 2000; 4 pasuri me 11550 m² AMTP me 14825 m² LN , tepër + 3275 m² në v.2003; 16 pasuri me 40928 m² AMTP me 84402 m² LN sipërfaqe tepër +43474 m², në vitin 2004; 2 pasuri me 7225 m² AMTP ,me 9716 m² LN , tepër + 2501 m² v. 2005; 1 pasuri me 1800 m² AMTP me

3300 m²LN tepër +1500 m² ne v.2006; 2. H. K. për 7 pasuri me sipërfaqe 16 250 m² AMTP, me 27 392 m² LN, tepër +11 142 m² (1 pasuri me 3000 m² AMTP, 3275 m² Ln tepër +275 m² ne v.2003; 4 pasuri me 12 250 m²AMTP, me 21 842 m² LN tepër + 9592 m² ne v.2003; 2 pasuri me 1900 m²AMTP, me 2275 m² LN tepër +1275 m²në v.2005); 3. G. S. për 3 pasuri me 2750 m² AMTP me 9950 m² LN, tepër +7 200 m² ndarë (1 pas me 250 m² AMTP me 900 m² LN tepër +650 m² ne v. 2004; 2 pasuri me 2500 m²AMTP me 9050 m²LN tepër + 6550 m² ne v. 2006), 4. E.D. për 2 pasuri me 4 820 m²AMTP, me 8250 m²LN,teper +3 430 m² ndarë (1 pasuri me 2320 m² AMTP, me 4000 m²LN tepër +1 780 m² në v..2006 dhe 1 pasuri me 2500 m²AMTP me 4250 m² LN tepër + 1750 m² në v.2008); 5. E. N. për 1 pasuri me 550 m² AMTP, me 900 m² LN, tepër +350 m², në vitin 2004. b. Ka lejuar e regjistruar kontrata shitje të individëve pa titull pronësie të sipërfaqes tepër pra pronësi “shtet” për 4 pasuri me sipërfaqe 10 900 m² AMTP me 13 960 m² LN me sipërfaqe tepër +3 060 m², pa veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqet e tepërta dhe shkaktuar dem ekonomik në vlerën 209,981 lekë nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie veprime këto të kryera nga personat H.K., R.T., E. D., S. O. dhe F. G. ish Regjistrues, R K ish Regjistrues, sipas tabelës.” Referencat dhe pasuritë bujqësore me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie zk 2039 Kalimash ARË”, c. Gjithashtu nuk janë kryer veprime në KPP pra nuk është veçuar e regjistruar “shtet” sipërfaqet tepër për 45 pasuri me sip 89 336 m² AMTP, me 172 255 m² LN, tepër +82 919 m², në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “Tokë bujqësore me sipërfaqe mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione e pa veçuar “Shtet” sipërfaqen tepër ZK 2039 Kalimash” (Trajtuar hollësisht në faqet 18-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 6: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 87 pasuri me sipërfaqe 192 099 m²sipas AMTP të llojit arë dhe 368 154 m² sipas LN PIII tepër +176 055 m² tokë bujqësore ndarë: 38 pasuri me sipërfaqe tepër +90 076 m², të regjistruar dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie dhe pa tjetërsuar, deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN,zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” dhe shfuqizimin e certifikatave, kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër, ndërsa për 4 pasuri me 10 900 m² AMTP me 13 960 m² LN me sipërfaqe tepër +3 060 m²shitur deri në arkëtimin e vlerës 209,981 lekë demit ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie dhe për 45 pasuri me sipërfaqe 89 336 m² AMTP, me 172 255 m² LN, tepër +82 919 m², pa veprime në KPP deri në veçimin e regjistrimin e sipërfaqes tepër “shtet”sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie ZK 2039 Kalimash” dhe ”Tokë bujqësore me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione e pa veçuar “Shtet” ZK 2039 Kalimash ZVRPP Kukës”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 6: ZVRPP Kukës në zk 2039 fshati Kalimash sipas listave te trojeve 001, për 51 raste k/familjar në 87 pasuri *truall* me 26 431 m² ka çelur KPP me sipërfaqe tepër +9283 m², nuk ka çelur KPP pa identifikuar 6 pasuri me sipërfaqe faktike 1848 m²; ka lëshuar certifikata me sipërfaqe tepër dhe pa titull pronësie për 6 pasuri me sipërfaqe tepër +848 m² para v. 2013 pa veçuar, e regjistruar “shtet” sipërfaqen tepër, si dhe nuk janë kryer veprime në KPP për 75 pasuri me 22 884 m², tepër +10 209 m², veprime këto të kryera nga z. E.D. për 2 pasuri me sipërfaqe tepër +250 m² para v.2013; z. R. T., për 2 pasuri me sipërfaqe tepër +300 m², para v.2013 dhe z. A. B., 2 pasuri me sipërfaqe tepër +298 m², para v.2013; si dhe nuk është identifikuar qartë në KPP emërimi dhe subjekti që ka nën administrim për 57 pasuri shtetërore troje e ndërtesa; veprime në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, dhe me nenin 10 të

Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978” Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave” ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²...” pasqyruar në tabelën emërtuar “**Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 2039 Kalimash Kukës**” (Trajtuar hollësisht në faqet 18-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 7: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 51 raste k/familjar në 87 pasuri truall me 26 431 m² me KPP me sipërfaqe tepër +9283 m² ndarë: për 6 pasuri me sipërfaqe tepër +848 m² me certifikata të lëshuara dhe për 75 pasuri me 22 884 m², tepër +10 209 m², pa veprime në KPP, deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, deri në shfuqizimin certifikatave të lëshuara dhe veçimin e regjistrimin shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim, pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 2039 Kalimash Kukës”

Brenda muajit Nëntor 2016

Rekomandim 8: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa të identifikojë dhe të çelë KPP për 6 pasuri me sipërfaqe faktike 1848 m² të llojit truall ndodhur në zk 2039 Kalimash, dhe gjithashtu të identifikojë qartë në KPP-të e çelura emërimin dhe subjektin që ka nën administrim për 57 pasuri shtetërore troje e ndërtesa të ndodhura në zk 2039 Kalimash, pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 2039 Kalimash Kukës”

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 7: ZVRPP Kukës në zk 2724 fshati Morinë për 193 pasuri me sipërfaqe 233 870 m² sipas AMTP të llojit arë dhe sipërfaqe 319 878 m² sipas LN PIII, pra të rezultuara tepër +80 008 m² tokë bujqësore, për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN PIII, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër,

a.Ka lëshuar certifikata për 126 pasuri me sipërfaqe tepër + 49 298 m², përkatësisht: nga punonjësit: 1. R. T., për 5 pasuri 6 503 m², AMTP me 8 506 m², LN tepër + 2 003 m², (1 pasuri me m²AMTP me 400 m² LN sipërfaqe tepër + 400 m² në v. 2001; 1 pasuri me 520 m²AMTP me 800 m²LN, tepër + 280 m² ne v.2003; 3 pasuri me 5 983 m² AMTP me 7306 m²LN sipërfaqe tepër +1323 m², ne vitin 2004; 2. H.K., për 66 pasuri me sipërfaqe 72905 m² AMTP, me 95 626 m² LN, tepër +22 721 m² ((54 pasuri me 61412 m² AMTP, me 80 162 m² LN tepër +18750 m² ne v.1998; 1 pasuri me 450 m²AMTP, 1400 m² LN, tepër + 950 m² ne v.2000; 3 pasuri me 5620 m²AMTP, me 7454 m² LN tepër +1834 m² në v.2004; 8 pasuri me 5423 m²AMTP, me 6610 m² LN v.2005); 3. Gj. S., për 1 pasuri me 2340 m²AMTP me 2632 m² LN, tepër +292 m² ne v. 2005; 4. E.D., për 13 pasuri me 17315 m² AMTP, me 21869 m² LN, tepër +4 554 m², (3 pasuri me 2660 m²AMTP, me 4260 m²LN tepër +1 600 m² në v. 2006; 3 pasuri me 6 437 m²AMTP, me 6 660 m²LN, tepër +223 m² në v. 2007 dhe 7 pasuri me 8218 m²AMTP me 10 949 m² LN tepër + 2731 m² në v. 2010); 5. E.N., për 6 pasuri me 3 990 m²AMTP, me 9141 m² LN, tepër +5151 m², në vitin 2004; 6. G. K. për 1 pas me 1 739 m²AMTP me 1 971 m² LN, tepër + 233 m², në vitin 2006; 7. My. K. për 15 pasuri me 16 542 m²AMTP me 24022 m² LN, tepër +7480 m², ne v. 1997-1998; 8. S. O. për 6 pasuri me 5593 m²AMTP me 6 925, m² LN, tepër + 1332, (1 pasuri me 989 m² AMTP me 1 100 m² LN tepër +111 m² ne v. 2008; 4 pasuri me 3944 m² AMTP me 5071 m² LN tepër +1127 m² ne v. 2010; 1 pasuri me 660 m² AMTP me 754m² LN tepër +94 m² ne v. 2014) dhe 9. Pa firma persona të identifikuar e pa data për 14 pasuri me 12 133 m²AMTP me 17 665 m² LN, tepër + 5 532 m².

b. Ka lejuar e regjistruar transaksione heqje nga BP, kontrata shitje apo shpronësime për autostradën të individëve mbi pasuritë me sipërfaqe tepër pa titull pronësie të sipërfaqes tepër pra pronësi “shtet” për 9 pasuri me sipërfaqe 13 162 m² AMTP me 7956 m² LN me sipërfaqe tepër +4794 m², pa veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqet e tepërta dhe shkaktuar dem ekonomik në vlerën 120,885 lekë nga shitja apo shpronësimi i sipërfaqes tepër “shtet”pa titull pronësie veprime këto të kryera nga personat *H.K.në vlerën 58645 lekë për veprimet në referencat. nr. 179. nr. 22, nr. 50 lidhur me pasuritë nr. 82/8, nr. 82/9, nr. 19/1, nr. 59/52, nr. 66/31; z. E. D. në vlerën 22,640 lekë për veprimet me referencën nr..104 lidhur me pasurinë nr. 35/29; z. G. I. në vlerën 39,600 lekë për veprimet me referencën nr. 204 lidhur me pasurinë nr. 163/9 sipas tabelës:*” Referencat dhe pasuritë Tokë Bujq Arë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shpronësim shitje pa titull pronësie zk 2724 Morinë”.

c. Gjithashtu nuk janë kryer veprime në KPP pra nuk është veçuar e regjistruar “shtet” sipërfaqet tepër për 58 pasuri me sip 87 649 m² AMTP, me 113 565 m² LN, tepër +25 916 m², veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“ dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “Tokë bujqësore me sipërfaqe mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione e pa veçuar “Shtet” sipërfaqen tepër ZK 2724 Morine” (*Trajtuar hollësisht në faqet 24-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 9: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 193 pasuri me 233 870 m²sipas AMTP të llojit arë dhe 319 878 m² sipas LN PIII, pra të rezultuara tepër +80008 m² tokë bujqësore ndarë: 126 pasuri me sipërfaqe tepër +49 298 m², të regjistruar dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie por të pa tjetërsuara dhe për 14 pasuri me 12133 m²AMTP me 17665 m² LN, tepër + 5 532 m², pa firma persona të identifikuar e pa data, *deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN, zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” dhe shfuqizimin e certifikatave, kthimin dhe regjistrimin “shtet”të sipërfaqeve tepër; ndërsa për 9 pasuri me sipërfaqe 13162 m² AMTP me 17956 m² LN me sipërfaqe tepër +4794 m², shitur deri në arkëtimin e vlerës 120,885 lekë demit ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie dhe për 58 pasuri me sipërfaqe 87649 m² AMTP, me 113565 m² LN, tepër +25 916 m², pa veprime në KPP deri në veçimin e regjistrimin e sipërfaqes tepër “shtet” sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie zk 2724 Morinë” dhe ”Tokë bujqësore me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata, kryer transaksione e pa veçuar “Shtet” zk 2724 Morinë ZVRPP Kukës”.*

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 8 : ZVRPP Kukës në zk 2724 fshati Morine sipas listave te trojeve 001,dhe PIII për 30 raste k/familjar në 62 pasuri *truall* me 21387 m² ka çelur KPP me sipërfaqe tepër +12087 m²; ka lëshuar certifikata me sipërfaqe tepër dhe pa titull pronësie për 19 pasuri me sipërfaqe *tepër* +4396 m² sipas periudhave: 15 pasuri me sipërfaqe tepër +3772 m² para v.2013 dhe 4 pasuri me sipërfaqe tepër +624 m² v.2014 veprime këto të kryera pa veçuar, e regjistruar “shtet” sipërfaqen tepër, përkatësisht nga: 1.z .E. D. lëshuar certifikata për 4 pasuri me sipërfaqe tepër + 948 m² v.2006-2008 , z. S. O. për 1 pasuri me+ 60m² para v.2010, z.G.I. për 4 pasuri me + 624 m²tepër v.14, znj. G. K., për 1 pasuri me +1457 m² tepër,v.06, znj.M. K. për 3 pasuri me + 628 m² tepër v.97-98, dhe pa identifikuar firmat në KPP për 5 pasuri me + 578 m² në v.2000 për 1 pasuri me +56 m² dhe 4 pasuri me +522 m² v. 2006; si dhe nuk janë kryer veprime në KPP për 42 pasuri me 13210 m², tepër +7210 m². Gjithashtu janë shpronësuar sipërfaqe tepër pa titull pronësie pasuria nr. 91/11 v.5 fq 235 zk. 2724 Morine me sipërfaqe 781 m² tepër +481 m² lëshuar c. 15.5.06 nga H. K. me pasojë dëmin ekonomik Buxhetit Shtetit në vlerën 649,350 lekë përfituar padrejtësisht nga Qytetari L.I.D.,

si vlerë shpronësimi i padrejtë sipas tabelës “Referencat dhe pasuritë truall me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shpronësim shitje pa titull pronësie zk.2724 Morinë”; veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, datë 29.6.1978” Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave” ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²...” pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 2724 Morinë Kukës” (Trajtuar hollësisht në faqet 24-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 10: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 30 raste k/familjar në 62 pasuri truall me 21387 m² me KPP me sipërfaqe tepër +12087m² ndarë: për 19 pasuri me sipërfaqe tepër +4396 m² me certifikata të lëshuara; për 10 pasuri me +1156 m² pa identifikuar firmat në KPP dhe për 42 pasuri me 13210 m², tepër +7210 m² pa veprime në KPP, deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991,deri në shfuqizimin certifikatave të lëshuara dhe veçimin e regjistrimin shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim, ndërsa për pasurinë nr. 91/11 v.5 fq 235 zk. 2724 Morinë me sipërfaqe 781 m² tepër +481 m² lëshuar c. 15.5.06 nga H. K.me pasojë dëmin ekonomik Buxhetit Shtetit në vlerën 649,350 lekë përfituar padrejtësisht nga Qytetari L.I. D.,deri në arkëtimin e vlerës pasqyruar tabelat “Referencat dhe pasuritë truall me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shpronësim shitje pa titull pronësie zk. 2724 Morinë”, dhe “Pasuri Truall me sipërfaqe tepër mbi normë me lista 001, Lëshuar certifikata dhe kryer transaksione në KPP zk 2724 Morinë Kukës”

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 9: ZVRPP Kukës në zk 1176 fshati Breglumë për 19 AMTP me 22 pasuri të llojit arë me sipërfaqe 29 223 m², sipas AMTP-ve dhe sipërfaqe 42215 m², sipas LN PIII pra të rezultuara tepër + 12992 m² tokë bujqësore, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet”sipërfaqen tepër,

a. ka lëshuar certifikata për 15 pasuri me 22480 m² sipas AMTP, 31700 m²LN, me sipërfaqe tepër + 10220 m², përkatësisht nga punonjësit: 1. H. K. për 9 pasuri me sipërfaqe 14845 m² AMTP, me 22300 m² LN, tepër +7455 m², (5 pasuri me 6225 m²AMTP, me 10200 m² LN, tepër + 3975 m² në v.98; 2 pasuri me 3745 m²AMTP, me 4400 m²LN, tepër + 655 m², në v.2004; 2 pasuri me 4875 m²AMTP, me 7700 m² LN, tepër + 2825 m² në v.2005); 2. R. T. për 1 pasuri me sipërfaqe 660 m²AMTP, me 900 m² LN, tepër + 240 m² në v.2004 ; 3.E. D. për 2 pasuri me sipërfaqe 2550 m²AMTP, me 3100 m² LN, tepër +550 m² në v.2006-2007; 4.A. B. për 1 pasuri me sipërfaqe 1500 m²AMTP, me 1700 m² LN, tepër +200 m² në v.2006, dhe 5. S. O. për 1 pasuri me sipërfaqe 1800 m²AMTP, me 2500 m² LN, tepër +700 m² në v.2009 6. Pa firma persona të identifikuar e pa data 1 pasuri 1125 m²AMTP me 1200 m² LN, tepër +75 m² në v.2003; pra veprimet janë kryer mbi pasuritë bujqësore me sipërfaqe tepër pa kryer më parë veçimin dhe regjistrimin “shtet”, të sipërfaqes tepër mbi normë, vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata dhe pa veçuar sipërfaqen tepër sipas veprimeve në Kartela zk 1176 Breglumë”.

b. Gjithashtu nuk janë kryer veprime në KPP pra nuk është veçuar e regjistruar “shtet” sipërfaqet tepër për 7 pasuri me 6743 m² AMTP, me 10515 m² LN me sipërfaqe tepër +3772 m² mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata

dhe pa veçuar sipërfaqen tepër sipas veprimeve në Kartela zk 1176 Breglumë” (*Trajtuar hollësisht në faqet 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 11: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60,74 për 19 AMTP me 22 pasuri të llojit arë me sipërfaqe 29223 m², sipas AMTP-ve dhe 42 215 m², sipas LN PIII pra tepër +12992 m² tokë bujqësore ndarë: 15 pasuri me 22480 m² sipas AMTP, 31700 m²LN, me sipërfaqe tepër +10 220 m², të regjistruar dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie dhe pa tjetërsuar deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN, zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” dhe shfuqizimin e certifikatave, kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër; dhe për 7 pasuri me 6743 m² AMTP, me 10515 m² LN me sipërfaqe tepër +3772 m² pa veprime në KPP deri në veçimin e regjistrimin e sipërfaqes tepër “shtet” sipas pasqyrës “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata dhe pa veçuar sipërfaqen tepër sipas veprimeve në Kartela zk 1176 Breglumë”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 10: ZVRPP Kukës në zk 1176 fshati Breglumë për 23 AMTP me 43 pasuri me 11476 m² ndarë; 21 pasuri truall me 6148 m² dhe 22 pasuri me 5328 m² toke bujqësore (arë-pemëtore), ka lëshuar certifikata me sipërfaqe tepër dhe pa titull pronësie për 13 pasuri me sipërfaqe tepër +3600 m² ndarë: 7 troje me sipërfaqe 2000 m² pa titull pronësie dhe 6 troje me sipërfaqe tepër +1600 m² nga 8 AMTP të korrigjuara me fshirje (AMTP nr. 9103, 9147, 9272, 9163, 9226, 9105, 9144, 9149, për të cilat nuk është kërkuar verifikimi), me mosrakordime të dhënave ndërmjet AMTP dhe të LN-PIII duke çelur KPP ndërsa nuk janë veçuar, çelur KPP regjistruar “shtet” për 9 pasuri me sipërfaqe tepër +2676 m² tokë bujqësore dhe 7 pasuri me 1605 m² fermerëve si dhe nuk janë kryer veprime në KPP për 10 pasuri me 3000 m² truall, veprime këto të kryera nga z. H.K., lëshuar certifikata 11 pasuri me 3000 m² truall ndarë: 7 pasuri me 2000 m² troje pa Titull Prone dhe 4 pasuri me sipërfaqe tepër +1000 m² mbi normë dhe znj. M. K.: lëshuar certifikata 3 pasuri me sipërfaqe tepër +900 m² truall ndarë; 2 pasuri me 200 m² truall pa titull prone me AMTP të korrigjuara dhe pa veçuar e regjistruar pasuritë bujqësore; në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, datë 29.6.1978” Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave” ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²...” pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasuri Tokë Truall me sipërfaqe tepër mbi AMTP, Lëshuar certifikata sipas veprimeve në KPP ZK 1176 Fshati Breglumë Kukës” (*Trajtuar hollësisht në faqet 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 12: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 23 AMTP me 43 pasuri me 11476 m² ndarë; 21 pasuri truall me 6148 m² dhe 22 pasuri me 5328 m² toke bujqësore (arë-pemëtore), përkatësisht: për 13 pasuri me sipërfaqe tepër +3600 m² ndarë: 7 troje me sipërfaqe 2000 m² pa titull pronësie dhe 6 troje me sipërfaqe tepër +1600 m² me origjinë prej 8 AMTP-ve të regjistruara dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie dhe pa tjetërsuar deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN, deri në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” dhe shfuqizimin e certifikatave, kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër; si dhe të kërkojë verifikimin e vlerësimit të titujve të pronësisë 8 AMTP-ve nr. 9103, 9147, 9272, 9163,

9226, 9105, 9144, 9149 sipas pasqyrës “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP, lëshuar certifikata dhe pa veçuar sipërfaqen tepër sipas veprimeve në Kartela zk 1176 Breglumë”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje : Në zonat jashtë sistemit të menaxhimit mungojnë e nuk disponohen nga ZVRPP Kukës listat e trojeve për 3 fshatra përkatësisht për zk. 2290, Fshati Kryemadh me 124 K/Familjarë, me 114 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve, në ZK.1697 fshati Gëdheshite me 74 K/Familjarë me 58 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve; dhe në ZK.3406 Fshati Shpat me 44 K/Familjarë me 36 nga 44 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr 7501 “Për tokën”, me Dekretin nr. 5747 dhe me VKM nr. 556, datë 23.10.2000 ‘Për dorëzimin e Dokumentacionit të Pronësisë në ZVRPP’ pasqyruar ne tabelën emërtuar “B. Fshatra dhe 30 ZK që Nuk kanë Lista 001 por trojet i kanë përfshirë brenda Kolonave të AMTP-ve“ (*Trajtuar hollësisht në faqet 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 13: ZVRPP Kukës të kërkojë pranë ish NJQV-ve dhe aktualisht pranë Bashkisë Kukës që nëpërmjet Njësive Administrative të hartonin listat e munguara dhe të pa dorëzuara të trojeve 001 sipas gjendjes së vitit 1991 për 3 fshatra si zk. 2290, Fshati Kryemadh me 124 K/Familjarë, me 114 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve, në ZK. 1697 fshati Gëdheshite me 74 K/Familjarë me 58 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve; dhe në ZK. 3406 Fshati Shpat me 44 K/Familjarë me 36 nga 44 troje të evidentuar të përfshira brenda AMTP-ve sipas ne tabelës emërtuar “B. Fshatra dhe 30 ZK që Nuk kanë Lista 001 por trojet i kanë përfshirë brenda Kolonave të AMTP-ve“.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 11 : Nga auditimi me zgjedhje i listave të trojeve 001 të administruara nga ZVRPP Kukës për fshatrat që kanë hartuar e dorëzuar këto lista rezulton se për 629 K/Familjarë sipas listave 001 shënohet sipërfaqja në fakt prej $261611 m^2$, e cila krahasuar me normën prej $300 m^2$ me sipërfaqe normë totale $133400 m^2$ truell, tregon se këto lista përmbajnë sipërfaqe tepër $+128211 m^2$ truell, që vjen nga pajisja me 2 e më shumë troje për K/Familjar dhe nga sipërfaqe mbi $300 m^2$, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“ dhe me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978 , datë 29.6.1978” Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave”, ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në $200 m^2$ në fshatrat kodrinore e malore deri në $300 m^2$ dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri $170 m^2$...” pasqyruar në tabelën emërtuar “A. Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara” (*Trajtuar hollësisht në faqet 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 14: -ZVRPP Kukës të kërkojë pranë ish NJQV-ve dhe aktualisht pranë Bashkisë Kukës nëpërmjet Njësive Administrative, verifikimin dhe saktësimin e listave të dorëzuara të trojeve 001 sipas gjendjes së vitit 1991 për 14 fshatra me 629 K/Familjarë ku sipas listave 001 shënohet sipërfaqja në fakt prej $261 611 m^2$ e cila krahasuar me sipërfaqen prej $133 400 m^2$ sipas normës prej $300 m^2$ tregon se këto lista përmbajnë sipërfaqe tepër $+128211 m^2$ truell që vjen nga pajisja me 2 e më shumë troje për të njëjtin K/Familjar dhe nga sipërfaqe mbi $300 m^2$, pasqyruar ne tabelën emërtuar “A. Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 12: ZVRPP Kukës dhe ZQRPP Tiranë kanë pranuar nga Nj.M. P. (NjMP) (në vitin 1995 kur zona ka hyrë në Sistemin e regjistrimit fillestar) dokumentacionin me mangësi për ZK 1176 Fshati Breglumë Printim III me gabime dhe librat e KPP-ve 2 volume duke lënë jashtë menaxhimit në sistem dhe pa çelur KPP për 194 pasuri me sipërfaqe $119526 m^2$ ose 12 ha tokë bujqësore arë pemëtore, që i përkasin 222 AMTP-ve ndërkohë që kanë çelur KPP për 256 troje (sipërfaqe të përfshira brenda AMTP-ve, dhe pa pasur listën e trojeve 001 të konfirmuar nga Kryeplaku dhe

Kryetari Komunës), gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” (*Trajtuar hollësisht në faqet 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 15: ZVRPP Kukës dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin dhe futin në sistem, të identifikojnë pasuritë e të çelin KPP-të për 194 pasuri me sipërfaqe 119526 m² tokë bujqësore që i përkasin 222AMTP-ve në ZK1176 Fshati Breglumë si dhe të kërkojnë pranë NJQV, Bashki Kukës konfirmimin e listës 001 së 256 trojeve për të cilat janë çelur KPP.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 13: ZVRPP Kukës nuk ka çelur KPP, PIII dhe nuk ka bërë azhurnimin që u përkasin 32 ZK-ve të menaxhuara në sistem deri në v.2004, për 255 AMTP-ve me sipërfaqe 1,117,910 m² ose 111,79 ha tokë bujqësore të dërguara nga Qarku pas viteve 2007-2014; për pasojë nuk janë menaxhuar këto pasuri të shpërndara në 453 parcela; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “ Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, pasqyruar në tabelën emërtuar:” Trajtimi i AMPT-ve Shtese dhe Nevojat per Menaxhim e Çelje KPP” (*Trajtuar hollësisht në faqet 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 16: ZVRPP Kukës dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin dhe futin në sistem, të identifikojnë pasuritë e të çelin KPP-të për 255 AMTP-të me sipërfaqe 1,117,910 m² ose 111,79 ha tokë bujqësore të dërguara nga Qarku pas viteve 2007-2014; të shpërndara në 32 zona kadastrale dhe 453 parcela pasqyruar në tabelën emërtuar:” Trajtimi i AMPT-ve Shtese dhe Nevojat për Menaxhim e Çelje KPP”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 14: ZVRPP Kukës me referencën nr. 33, datë 31.7.2015, ka pajisur subjektin “V.D. I-E.”,SH.P.K, me certifikatën nr. 2328 “Për Vërtetim Titulli “Në Përdorim” lëshuar datë 27.7.2015, regjistruar në seksionin “D” për pasurinë nr. 405/3,v. 2, f. 240, zk. 1653 ”karrierë”, sipërfaqe 41 000 m² ose 4,1 ha, ish sipërfaqe pyjore dhënë me të drejtë përdorimi për aktivitet shfrytëzimi minerar sipas VKM nr. 51, datë 21.01.2015 “Për Heqjen nga Fondi Pyjor dhe Kullor të Sipërfaqes, në Ngastrat e Ekonomisë Pyjore “Mamëz-Kalimash”, të Rrethit Kukës, që do të Përdoret nga Shoqëria “V.D. I-E.”,SH.P.K, për Ushtrimin e Aktivitetit Minerar”. Ky regjistrim dhe lëshimi i certifikatës përdorimit është bërë me mangësi në dokumentacion dhe në mosplotësim plotësim të detyrimit të pikave 2, 3 të VKM nr. 51, datë 21.01.2015, pasi ZVRPP Kukës nuk ka kërkuar dhe ndaj subjektit dhe nuk disponon në dosjen e referencave dokumentacioni:

1. Mungon dokumentacioni i shlyerjes së detyrimit për vlerën përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore për sipërfaqen 38150 m² pasuria nr. 403/2, v.2,f.237 zk.1653 pyll, nga subjekti “V.D. I-E.”,SH.P.K,vlerësuar sipas pikës 4 të VKM nr.391, datë 21.6.2006”Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”; në mos plotësim të detyrimit të pikës 2, të VKM nr.51, datë 21.01.2015.

2. Mungon dokumentacioni i Planit të Rehabilitimit të sipërfaqes 4,1 ha për pyllëzim brenda 3 vjetësh në ngastrat e përcaktuara, në Marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit, pra mungon kjo marrëveshje, mungesë kjo në mosplotësim të pikës 3 të VKM nr.51, datë 21.01.2015, ku shprehet: ”Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi,shoqëria “V.D. I-E.”,SH.P.K., detyrohet të rehabilitoje sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas planit të rehabilitimit mjedisor dhe, brenda 3 viteve të para të pyllëzohet me fondet e veta, një sipërfaqe prej 4,1 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit” (*Trajtuar hollësisht në faqet 16-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 17: ZVRPP Kukës Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për pasurinë nr. 405/3, v. 2, f. 240, zk. 1653 ”karrierë”, si dhe të kërkojë shfuqizimin e certifikatës nr. 2328 “Për Vërtetim Titulli “Në Përdorim” lëshuar datë 27.7.2015, regjistruar në seksionin “D” deri plotësimin, dorëzimin nga subjekti V.D. I.-E.”, SH.P.K, të dokumentacionit të shlyerjes së detyrimit për vlerën përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore për sipërfaqen 38150 m² pasuria nr. 403/2, v.2,f.237 zk.1653 pyll si dhe të dokumentacionit Planit të Rehabilitimit të sipërfaqes 4,1 ha për pyllëzim brenda 3 vjetësh në ngastrat e përcaktuara, në Marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit. Dokumentacioni të përfshihet e bëhet pjesë e dosjes se referencës nr. 33, datë 31.7.2015, dhe të shërbejë për kryerjen e regjistrimeve pasuese në zbatim të marrëveshjes së mësipërme.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 15: ZVRPP Kukës me shkresën nr.4, datë 05.01.2016, në përgjigje të aplikimit nr. 3717, datë 28.12.2015 të subjektit “Ä.G”, Shpk, praktikë mbetur në proces, për regjistrimin e të drejtave të marrjes në përdorim të pasurive sipas VKM nr. 972, datë 2.12.2015 ”Për Heqjen nga Fondi Pyjor dhe Kullosor të Sipërfaqes, në Ngastrat e Ekonomisë Pyjore “Mamëz-Kalimash”, të Rrethit Kukës, që do të Përdoret nga Shoqëria “A G”, SH.P.K për Ushtrimin e Aktivitetit Minerar në Shfrytëzimin e Kromit”, pra në shkresën nr.4, datë 05.01.2016 ka kërkuar planvendosjen e pasurive dhe zbatimin e procedurave për ndarjen apo bashkimin e pasurive; por nuk ka bërë identifikimin e çeljen e KPP të pasurisë dhe nuk ka kërkuar ndaj subjektit edhe dokumentacionin përkatësisht :

1. Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimit për vlerën përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore për sipërfaqen 29,5 ha (pasi të identifikohen pasuritë e shtrira në ngastrat 92a, 92b, 93a, 93b, 94a, 94b të Ekonomisë pyjore “Mamëz-Kalimash”), nga shoqëria “A. G.”, SH.P.K vlerësuar sipas pikës 4 të VKM nr. 391, datë 21.6.2006”Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”; në plotësim të detyrimit të pikës 2, të VKM nr. 972, datë 2.12.2015 ku shprehet : “ Vlerat përkatëse të pakësimit të lëndës drusore të sipërfaqes së hequr e infrastrukturës së saj paguhen nga shoqëria “A. G.”, SH.P.K në bazë të lidhjes 4, të VKM nr. 391, datë 21.6.2006”Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

2. Dokumentacioni i Planit të Rehabilitimit të sipërfaqes 88,5 ha fond pyjor brenda 3 vjetësh në ngastrat e përcaktuara, në Marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit, në plotësim të pikës 3 dhe pikës 4, të VKM nr. 972, datë 2.12.2015 ku shprehet: ”Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “A. G.”, SH.P.K, detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 3 viteve të para të pyllëzimit me fondet e veta, një sipërfaqe prej 88,5 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit”(Trajtuar hollësisht në faqet 16-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 18: ZVRPP Kukës, për vazhdimin e aplikimit nr. 3717, datë 28.12.2015 bërë nga subjekti Ä. G.”, Shpk, praktikë e mbetur në proces për regjistrimin e të drejtave të marrjes në përdorim të pasurive sipas VKM nr. 972, datë 2.12.2015, të bëjë identifikimin dhe të çelë KPP e pasurisë prej 29,5 ha, të shtrirë në ngastrat 92a, 92b, 93a, 93b, 94a, 94b të Ekonomisë Pyjore Mamëz-Kalimash, që kthehet në karrierë për aktivitet shfrytëzimi minerar shoqërisë “A.G.”, SH.P.K, sipas VKM nr. 972, datë 2.12.2015 “Për Heqjen nga Fondi Pyjor dhe Kullosor të Sipërfaqes, në Ngastrat e Ekonomisë Pyjore “Mamëz-Kalimash”, të Rrethit Kukës, që do të Përdoret nga Shoqëria “A.G.”, SH.P.K.

Brenda muajit Nëntor 2016

Rekomandim 19: ZVRPP Kukës, në përgjigjen e aplikimit nr. 3717, datë 28.12.2015 për regjistrimin e të drejtave të marrjes në përdorim të pasurive sipas VKM nr. 972, datë

2.12.2015, përveç sa kërkuar me shkresën nr.4, datë 05.01.2016, të kërkojë dhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimit për vlerën përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore për sipërfaqen 29,5 ha (pasi të identifikohen pasuritë e shtrira në ngastrat 92a, 92b, 93a, 93b, 94a, 94b të Ekonomisë pyjore "Mamëz-Kalimash"), nga shoqëria "A G", SH.P.K vlerësuar sipas pikës 4 të VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave"; në plotësim të detyrimit të pikës 2, të VKM nr. 972, datë 2.12.2015 ku shprehet: "Vlerat përkatëse të pakësimit të lëndës drusore të sipërfaqes së hequr e infrastrukturës së saj paguhen nga shoqëria "A G", SH.P.K në bazë të lidhjes 4, të VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar.

2. Dokumentacioni i Planit të Rehabilitimit të sipërfaqes 88,5 ha fond pyjor brenda 3 vjetësh në ngastrat e përcaktuara, në Marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit, në plotësim të pikës 3 dhe pikës 4, të VKM nr. 972, datë 2.12.2015 ku shprehet: "Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria "A. G", SH.P.K, detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 3 viteve të para të pyllëzimit me fondet e veta, një sipërfaqe prej 88,5 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit".

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 16: ZVRPP Kukës, për disa vite radhë nuk ka evidentuar raportuar rehatuar gjendjen dhe regjistrimin e pasurive me mbivendosje.

Gjithashtu ZVRPP Kukës ka krijuar mbivendosje, ka krijuar relative të pa saktë të pasurive të regjistruara me mbivendosje, me trajtim të pabarabartë të palëve, nuk ka marrë e masa në kohë e ndjekur procedurat ligjore për zgjidhjen e mbivendosjeve, në moszbatim të afatit 1 mujor të KPA, mos nxjerrjen e urdhrat administrativ për refuzimin e regjistrimit, të pjesëve të mbivendosura, në kundërshtim me Kreun V, nenit 37, paragrafi i 3, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, me nenin 10 dhe 44 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe me rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme"; lidhur me pasuritë e regjistruara me mbivendosje të trefishtë përkatësisht:

a. Pasuria emërtuar objekt oficinë me sipërfaqe ndërtimi 190 m² llojit ndërtesë 2kt regjistruar në pronësi të Xh.L.C. sipas Regjistrimit hipotekor nr.1, viti 1991, faqe 119, indeksi nr.11, datë 4.2.1994; blerë nga ish-NTSH Kukës sipas kontratës shitblerjes nr.381 rep datë 03.02.1994; më tej kjo pasuri ka kaluar në regjistrin hipotekor nr. 2 viti 1995-1996-1997, faqe 35, indeksi nr.55, datë 26.3.1998, me regjistrim të aktit noterial nr.1002, datë 4.07.1996, shitur nga Xh.L.C në pronësi të blerësit A.E.

b. Pasuria emërtuar objekt-magazinë oficine me sipërfaqe ndërtimi 190 m² llojit ndërtesë 2kt regjistruar në pronësi të B.E. sipas Regjistrimit hipotekor nr.2, viti 1995-1996-1997, faqe 21, indeksi nr.14, datë 8.2.1996, blerë nga ish-NTSH Kukës sipas kontratës shitblerjes nr. 211 rep datë 08.02.1996;

c. Pasuria emërtuar objekt-zyra-Kapanone me sipërfaqe ndërtimi 384 m², lloji ndërtesë 2kt regjistruar në pronësi të A. Z. sipas Regjistrimit hipotekor nr.2, viti 1995-1996-1997, faqe 79, indeksi nr.18, datë 26.3.1998, blerë nga ish-NTSH Kukës sipas kontratës shitblerjes nr. 323 rep datë 17.3.1998; transferuar me referencë nr.04607, datë 09.11.2000 kaluar nga hipoteka në regjistrin sporadik emërtuar pasuria nr. 2/86-N, v.18, f.47 zk.2315 objekti me 395 m², me sipërfaqe tepër +11 m² (Trajtuar hollësisht në faqet 160-164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 20: ZVRPP Kukës Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 të njoftojë palët dhe orientojë zgjidhjen gjyqësore, përkatësisht:

a.-për pasuritë emërtuar objekt oficinë me sipërfaqe ndërtimi 190 m² e llojit ndërtesë 2kt regjistruar në regjistrin hipotekor nr.1, viti 1991, faqe 119, indeksi nr.11, datë 4.2.1994; në pronësi të Xh.L.C

transferuar në regjistrin hipotekor nr. 2 viti 1995-1996-1997, faqe 35, indeksi nr.55, datë 26.3.1998 në emër të A. E.

b.-për pasuritë emërtuar *objekt-magazinë ofiçine* me sipërfaqe ndërtimi 190 m² e llojit ndërtesë 2kt regjistruar në regjistrin hipotekor nr.2, viti 1995-1996-1997, faqe 21, indeksi nr. 14, datë 8.2.1996, në pronësi të B. E. dhe,

c.-për pasuritë emërtuar *objekt-zyra-Kapanone pasuria nr. 2/86-N, v.18, f.47 zk.2315 objekti me 395 m², me sipërfaqe tepër +11 m²* në emër të A. Z.

Brenda muajit Nëntor 2016

Rekomandim 21: ZVRPP Kukës Regjistruesi të marrë masa, për evidentuar raportuar relatuar gjendjen dhe regjistrimin e pasurive me mbivendosje , mbetur pa identifikuar evidentuar disa vite radhë, si dhe të zbatojë procedurat e duhura ligjore për trajtimin e pasurive regjistruar me mbivendosje.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 17: ZVRPP Kukës *ka pamjaftueshmëri pune në:* 1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 5 vitesh deri ne vitet 2015 arrijnë në rreth mbi **112** me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht **446** mijë lekë, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Kukës ndaj publikut, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, sipas tabelës “Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara shërbim prej para Vitet 2012- 2015”, në kundërshtim e ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”,

2. Pamjaftueshmëri e bazës nënligjore aktuale, në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës lidhur me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin”, lidhur me mungesën e një rregullore të brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Kukës, të miratuar nga Kryeregjistruesi për periudhën e mëparshme dhe për vitet 2011-2013, lidhur me faktin që Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhet përmbledhur e bërë e plotë, por nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” ,

3. Për pasojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi, shërbimit të IT dhe sidomos lidhur me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve, me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, si dhe lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj.,pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*Trajtuar hollësisht në faqet 164-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 22: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marre masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e **112** praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5 vitesh deri ne vitet 2015, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht 446 mijë lekë, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Kukës ndaj publikut, dhe të administrohen në arkivë

dokumentacioni përkatës i praktikave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, rregullores nr. 2079, datë nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, sipas tabelës “Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara shërbim prej para Vitet 2012- 2015”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Rekomandim 23: ZQRPP dhe ZVRPP Kukës të ndjekin hapat e duhur ligjor për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të vendosin Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) si dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë Rregulloren e brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Kukës, si njësi e vetme në territorin vendor, bazuar ne organikat dhe organigramën dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013 të Kryeministrit”. Në Rregullore të përfshihen, përcaktohen, shkruhen, kushtet e pranimit, testimi fillestar të aftësive profesionale dhe trajnimit në vazhdim të punonjësve në ZVRPP, statusi i të punësuarve, përcaktimi i kryerjes së detyrave, ushtrimi i kompetencave dhe mbajtja e përgjegjësive për secilin specialist, Regjistrues, zv. Regjistrues juristëve dhe punonjës të tjerë, si dhe detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi dhe administrimin e dokumentacionit; si dhe për të gjitha këto procese dhe të punësuar të përcaktohen e vendosen SMKB (Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm) masa këto të detyrueshme në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 18 : Nga 12 raste të audituara sipas pasqyrës nr. 1, si më sipër në 11 raste nuk është veçuar pasuria shtet për sipërfaqen prej 10680 m² dhe në 6 raste janë kryer edhe transaksione. Nuk ka urdhër të regjistruesit për ndarje pasurie (Trajtuar hollësisht në faqet 56-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 24: Nga ZVRPP Kukës të merren masa për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit për pasuritë me numër rendor 1, 2, 3, 5, 7, 9 dhe 11 evidentuar në pasqyrën nr. 1, deri në kryerjen e veprimeve për veçimin e pasurisë shtet si dhe në çdo rast të ndarjes së pasurisë.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 19: në 1 rast sipas nr. 12 rendor të pasqyrës nr. 1 është ndryshuar zëri kadastral nga Mezhde në truall dhe Ledh pa u miratuar nga organet kompetente, dhe pa argumentim ligjor (Trajtuar hollësisht në faqet 56-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 25: Nga ZVRPP Kukës për ndryshimin e zërit kadastral të merren masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit sipas pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor për miratimin e ndryshimit të zërit kadastral nga organet që e kanë në kompetencë.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 20: Në dy raste sipas nr. rendor 7 dhe 9 të pasqyrës nr. 1, AMTP nr. 10209 dhe 10244 janë të panënshkuara nga pronari dhe kryetari i komisionit tokës, nuk plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të

pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar hollësisht në faqet 56-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 26: Nga ZVRPP Kukës të merren masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit sipas pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe ti dërgohen AMTP nr. 10209 dhe 10244 për verifikimin e statusit ligjor të titujve të pronësisë nga Bashkia Kukës në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, shkronja “ç”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 21 : Regjistrimi i trojeve dhe shtëpive me 0001, në zonat urbane të fshatit në zbatim të VKM Nr. 432 datë 14.08.1995, është bazuar në një listë dërguar nga Komuna për fshatin Gabricë me nënshkrimin e Kryetarit të Komunës dhe Kryeplakun e fshatit Gabricë, pa dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Auditimi i dokumentacionit rezultoi të jenë regjistruar sipërfaqe më shumë se norma 455 m² në 2 raste, në papajtueshmëri me nenin 24/a të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 i ndryshuar mbasi duhet të ishte refuzuar regjistrimi dhe dhënia e certifikatës së pronësisë, ndërsa evidentohen në listë sipas subjekteve 33 raste me sipërfaqe më tepër 4475 m² nga sa përcaktohet sipas VKM Nr. 432 datë 14.08.1995 dhe me dekretin nr. 5747, datë 29.06.1978 (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 27: ZVRPP Kukës të marrë masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit për 2 pasuri evidentuar në pasqyrën nr. 2, përkatësisht me nr. rendor 1 dhe 4 me sipërfaqe 455 m² ndërsa për 33 rastet e tjera evidentuar në pasqyrën nr. 2 për sipërfaqen 4475 m² në momentin e aplikimit për regjistrim të kërkohet plotësimi i dokumentacionit të duhur ligjor nga organet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Bashki sikurse kërkohet nga VKM Nr. 432 datë 14.08.1995 dhe dekreti nr. 5747, datë 29.06.1978.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 22 : Gjatë regjistrimit të objekteve me leje ndërtimi Ndërtesa-Pallate dhe Banesa nuk është arkëtuar detyrimi për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta për 2 subjekte me një vlerë prej 177500 lekë, sipas pasqyrës 2, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa”, pika 2.

U konstatua mospërputhje e sipërfaqes së ndërtimit sipas studimit, lejes së ndërtimit me sipërfaqet sipas vendimit të Këshillit Bashkiak.

Në përfundim të ndërtimit të pallatit është bërë ndryshim projekti sipas Vendimit të Kryetarit të Bashkisë 03/1, datë 12.03.2014, për sipërfaqe në rritje prej 188 m² e cila nuk evidentohet në akt-kolaudim, në papajtueshmëri me ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” për ndryshime në projekt. Projekt-Zbatimi nuk evidenton ndryshimet në projekt dhe është pa vula. Në praktikat e regjistrimit mungojnë Kontrata e këmbimit ndërmjet investitorit dhe pronarëve të truallit, relacion gjeologjik, relacioni sizmik, rekcioni për mbrojtjen kundra zjarrit, relacioni për sistemimin e objektit, preventivi dhe situacioni përfundimtar i objektit, licenca e investitorit, drejtuesit të punimeve, projektuesit, kolaudatorit, supervizorit, mungojnë aktet e kontrollit, mungon marrja në dorëzim e infrastrukturës Inxhinjerie, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të VKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar hollësisht në faqet 82-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 28: Nga ZVRPP Kukës të merren masa për nxjerrjen e urdhrave të kufizimit për subjektet evidentuar në pasqyrën nr. 3, si më si më lartë deri arkëtimin e detyrimit prej 177,500 lekë

nga 2 subjektet “A” shpk dhe “A. K.” dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në zbatim të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 23: Në 4 raste sipas referencave nr. 045-0944, 047-944, 044-944 dhe 046-944 janë bërë shtesa e korrigjime në AMTP për një sipërfaqe prej 10832 m².

Në 4 raste sipas referencave 019-0947, 050-0947, 053-0947,053-944 janë regjistruar dhe kanë kaluar në favor të subjektit A. C. me shpronësim pa pasur AMTP një *sipërfaqe 23778 m²* nga duke shpërblyer subjektet në vlerën **14,266,800 lekë**, duke i shkaktuar dëm ekonomik shtetit.

Në 1 rast sipas referencë nr. 0005 regjistruar pasuria 760/6 për 2889 m² e shpronësuar me AMTP shtesë nr. 11843/1, datë 06.06.2004(I. M.) kur AMTP e mëparshme me këtë nr. në emër të I. M. nuk ekziston. Nga auditimi i dokumentacionit për 65 rastet e subjekteve të shpronësuara dokumentacioni i fitimit të pronësisë është bërë me mangësi dhe jo sipas procedurave për ndarjen e tokës. Në të gjitha rastet e regjistrimeve të dokumentacionit të pronësisë nuk ka vendime të komisionit të ndarjes tokës në qark për miratimin e dokumentacionit të komunës si dhe shkresa përcjellëse nga KQ. Gjatë auditimit të dokumentacionit konstatohet se plotësimi i AMTP shtesë nuk përputhet me AMTP e mëparshme në emër apo në nr. Në disa raste AMTP nuk janë nënshkruar nga pronari por nga të tjerë, pa prokurë apo dëshmi trashëgimie, apo ndonjë dokument tjetër. *(Trajtuar hollësisht në faqet 112-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 29: Nga ZVRPP Kukës të merren masa për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit për 65 subjekte të evidentuara në pasqyrën 4-5 për pasuritë e regjistruara pa dokumentacionin e duhur ligjor si rezultat i shpronësimit deri në verifikimin e statusit ligjor të pronësisë nga Bashkia Kukës në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, shkronja “ç”. në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për shkeljet e konstatuara.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 24: Në ZVRPP Kukës nga auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimet fillestare të kryera, për pasuritë e fituara me AMTP, në ZK 2208, fshati Kolsh Kukës, doli se:

- në 12 raste është regjistruar një sipërfaqe prej **20.639 m²** më tepër se sa përmban dokumenti ligjor Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi të lëshuara nga komisioni i ndarjes së tokës në fshat, pasi janë pajisur me certifikatë pronësie me sipërfaqe sipas LN të muajit shkurt 1996, pra nuk është bërë ndarja e sipërfaqeve të tepërta dhe të regjistroheshin në KPP me pronar “shtet”.

- nga auditimi me të zgjedhur doli se në **11 raste** janë kryer regjistrime për një sipërfaqe prej **81785 m²** nga të cilat 36164 m² pemëtoare dhe 44.21 m² tokë arë sipas AMTP-ve shtesë të dërguara DAMT Këshilli i Qarkut Kukës, duke u vendosur i njëjti nr. i AMTP-së të plotësuar në vitin 1994, pët të cilat nuk disponohen të dhëna si norma për frymë sa ka marrë më parë dhe sa duhet të marrë, mbasi për rastet që kanë përfituar nuk është bërë një analizë e tillë

Nga auditimi i AMTP-ve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat për fshatin Kolsh Kukës del se nga ana formale nuk janë të plotësuara me të gjitha kërkesat e vetë formatit dhe konkretisht për 11 raste nuk janë shënuar kufizimet e pasurive, pa nënshkruar personi përfitues, etj, veprime në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç” pika 2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe shkronja “a” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” dhe të kërkonte nga komuna nga ka ardhur kërkuesi në se ka përfituar tokë sipas ligjit nr. 7501, datë 01.08.1991 “Për Tokën” *(Trajtuar më hollësisht në faqet 60-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 30: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 134/1, volum 3, faqe 2; nr. 295/6, volum 3, faqe 8; nr. 295/23, volum 3, faqe 9; nr. 256/5, volum 3, faqe 21; nr. 103/2, volum 3, faqe 23; nr. 99, volum 3, faqe 189; nr. 316/15, volum 4, faqe 49; nr. 117/13, volum 4, faqe 27; nr. 301/15, volum 4, faqe 31; nr. 318/13, volum 4, faqe 45; nr. 328/2, volum 3, faqe 47; nr. 295/17, volum 3, faqe 235; nr. 103/2, volum 3, faqe 23; nr. 301/13, volum 4, faqe 30, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 25: Në ZVRPP Kukës nga auditimi i pranimit të dokumentacionit në lidhje me regjistrimin e trojeve sipas listës së dërguar nga kryepleqtë e fshatrave të miratuara nga kryetari i komunës për ZK nr. 1645, fshati Fshat, ZK nr. 2208, fshati Kolsh, ZK nr. 2614, fshati Matranxhe, ZK nr. 1733, fshati Gjegje dhe nr. 3388, fshati Shkinak doli se jo për të gjitha fshatrat disponohen lista të 001 për ndërtimet e kryera para vitit 1990 dhe konkretisht:

a- Në ZK nr. 1645, fshati Fshat sipas listës së dërguar nga komuna Grykë Çajë dhe kryeplaku rezultoi se lista e trojeve dhe e shtëpive të ndërtuara para vitit 1990, përmban 199 troje dhe ndërtesa, ku në 40 raste përmban sipërfaqe prej 6.175 m² më shumë se sa u takonte të merrnin në bazë të VKM nr. 432, datë 14.8.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, nga të cilat vetëm në një rast është pajisur me certifikatë pronësie për një sipërfaqe 1021 m² nga 300 m² që duhet, pra me një sipërfaqe prej më **shumë 721 m²**, regjistruar në volum 1, faqe 111, pasuria nr. 259.

b- Në ZK nr. 2208, fshati Kolsh del se nuk disponohen lista të trojeve dhe shtëpive të ndërtuara para vitit 1990, të ardhura nga komuna Kolsh dhe kryeplaku i fshatit Kolsh, por nga auditimi i volumeve të kësaj zone doli se Njësia e Menaxhimit të Projektit me datë përfundimtare 17.12.1996, ka hapur 141 raste regjistrimi në KPP, nga të cilat një pjesë e tyre vetëm për 37 raste trulli është përfshirë në AMTP.

Nga auditimi me të zgjedhur i disa KPP dhe dokumentacionit përkatës për raste e plotësimit të certifikatave të pronësisë del se në 6 raste, prej 750 m² dhe konkretisht në volum 3, faqe 164, pasuria nr. 357/3 trull në emër të Gj. Ll. M. plotësuar certifikata e pronësisë me datë 27.01.2015, trull me sipërfaqe 300 m², nga kjo ndërtesë 80 m², me përshkrimin sipas AMTP-së nr. 126, mbasi u bë verifikimi i saj doli se përmban 250 m² trull dhe jo 300 m², pra dhënë më tepër 50 m² trull pa dokument ligjor dhe titull pronësie, ndërsa 5 rastet e tjera janë pajisur me certifikatë pronësie para vitit 2010, gjithashtu duke shqyrtuar rastet e kartelave të plotësuar del se në 34 raste është shënuar trull, pa sipërfaqe ndërtimore, ose në 8 raste del se ka persona me dy e tre troje, me një sipërfaqe prej 1.880 m² më shumë.

c- Në ZK nr. 2615 fshati Matranxhe, sipas listës së dërguar nga komuna Grykë Çajë dhe kryeplaku rezultoi se lista e trojeve dhe e shtëpive të ndërtuara para vitit 1990, përmban 59 troje dhe ndërtesa, ku në 39 raste përmban sipërfaqe prej 4.607 m² më shumë se sa u takonte të merrnin në bazë të VKM nr. 432, datë 14.8.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, nga të cilat vetëm në një rast është pajisur me certifikatë pronësie për një sipërfaqe 812 m² nga 300 m² që duhet, pra me një sipërfaqe prej më **shumë 522 m²**, regjistruar në volum 2, faqe 35, pasuria nr. 337/8.

d- Në ZK nr. 1645, fshati Gjegje sipas listës së dërguar nga komuna Grykë Çajë dhe kryeplaku rezultoi se lista e trojeve dhe e shtëpive të ndërtuara para vitit 1990, përmban 44 troje dhe ndërtesa, ku në 11 raste përmban sipërfaqe prej 1.898 m² më shumë se sa u takonte të merrnin në bazë të VKM nr. 432, datë 14.8.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, nga të cilat vetëm në një rast është pajisur me certifikatë pronësie për një

sipërfaqe 437 m² nga 300 m² që duhet, pra me një sipërfaqe prej më *shumë 137 m²*, regjistruar në volum 1, faqe 76, pasuria nr. 50/10.

Në zbatim të pikës 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, për pasuritë e paluajtshme të fituara në bazë të ligjeve të urbanistikës, në vartësi të viteve dhe të ndarjes administrative qytet/fshat për ndërtimet e kryera para vitit 1990 në fshat, baza ligjore është Dekreti nr. 5747, datë 29.06.1978, neni 10, përcaktohet: “Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore është në “përdorim” një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m².”

Përfitimi i sipërfaqes prej 1.370 m² nga individ të ndryshëm për 3 raste nuk është rrjedhim i një prej mënyrave të përcaktuara për fitimin e titullit të pronësisë në nenet 162 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i RSH” i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 60-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 31: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në ZK nr. 1645, fshati Fshat pasuria nr. 259, volum 1, faqe 111; në ZK nr. 2208, fshati Kolsh, pasuria nr. 337/8, volum 2, faqe 35; në ZK nr. 1614, fshati Matranxhe, pasuria nr. 337/8, volum 2, faqe 35 dhe në ZK nr. 1645, pasuria nr. 50/10, volum 1, faqe 76, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 26: ZVRPP Kukës në **13 raste**, në zonat urbane nr. 2315 qytet Kukës dhe në një rast në ZK nr. 2208, fshati Kolsh, ka regjistruar leje ndërtimi me mungesa në dokumentacionin tekniko-ligjor si: nuk ka projekt dhe preventiv të miratuar për objektin që do të ndërtohet, nuk ka kontrata me subjektet ndërtuese apo marrëveshje paraprake ndërtimi midis palëve, nuk ka akte të piketimit të objektit, për objektet e pajisura me leje përdorimi aktkolaudimi, nuk ka asnjë specifikim, pra është formal dhe planimetria e sheshit të ndërtimit, pa përkthim të kondicioneve si dhe dokumentacioni tjetër që individualizojnë ndërtimin e objektit, veprime në papajtueshmëri me nenin 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” dhe ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”.

Në 5 raste del se nga kryetari i Bashkisë Kukës janë marrë vendime për miratimin e ndryshimeve të projektit, bazuar në ligjin nr. 10119, darë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” për objektet të miratuara me vendime të KRRT-së të pa mbështetura në ligj mbasi:

- së pari nuk është bërë miratimi i Planit Rregullues nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bazë të neneve 40 dhe 41 Seksioni i dytë i Planifikimit Vendor të ligjit nr. 10119, datë 3.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

- së dyti këto objekte janë miratuar me vendime të KRRT-së, pra nga një organ kolegjal dhe se ndryshimet për këto raste duhet të bëhen vetëm nga gjykata mbasi kryetari i vetëm nuk ka tagër që të ndryshojë një vendim kolegjal.

- së treti në momentin e ndryshimeve të bëra funksionon ligji nr. 10119, darë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” dhe se në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 10119, darë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, Kreu VII Rregullorja e kontrollit të Zhvillimit të Territorit” nuk është miratuar plani i përgjithshëm rregullues nga AKPT-ja,

Në përfundim këto raste duhej të trajtoheshin si ndërtime pa leje dhe të nënshtroheshin vlerësimit të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 nga ALUIZNI.

Në 1 rast në ZK nr. 2208 del se ka mos përputhje të vendit të miratimit të lejes së ndërtimit të objektit “pikë shitje karburanti”, me ndërtimin faktik të tij nga Fushë Dukagjin në vendin e quajtur “shullo” dhe se origjina e pronës është përfutur me AMTP në zërin kadastral arë por në fakt sipas

LN të vitit 1991 është në zërin kadastral tokë e pa frytshme, gjithashtu në momentin e miratimit të lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit të “pika karburanti” nuk ka qenë pronar.

Në të gjitha rastet mungojnë, vërtetimet degës Tatim Taksave për shlyerjen e detyrimeve të subjekteve ndërtues dhe dokumente të tjera që individualizojnë ndërtimin e këtij objekti në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim dhe licenca e subjektit ndërtues, etj., veprime me mospërputhje me nenet 23 dhe 42 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 4 të shtojcën nr. 2 të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve, që verifikohen nga ZVRPP dhe të procedurës për nxjerrjen e Urdhrit të regjistruarit”, ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, datë 17.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 86-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 32: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2315 për pasuritë nr. 40/124, volum 28, faqe 165; nr. 40/51, volum 28, faqe 179; nr. 28/147, volum 29, faqe 93; nr. 26/125, volum 28, faqe 203; nr. 35/233, volum 28, faqe 195; nr. 49/3, volum 29, faqe 46; nr. 28/151, volum 29, faqe 131; nr. 34/174, volum 28, faqe 135; nr. 29/150, volum 29, faqe 127; nr. 49/4ND, volum 29, faqe 66; nr. 34/175, volum 29, faqe 115; nr. 23/108, volum 28, faqe 28; nr. 47/32, volum 28, faqe 178 dhe në ZK nr. 2208, fshati Kolsh pasuria nr. 428/2, volum 4, faqe 116, truall me sipërfaqe 900 m², nga e cila 161 m² ndërtesë, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 27 : ZVRPP Kukës për periudhën janar - dhjetor 2014, rezultoi se në 23 praktika të audituara në **18 raste** me 4671,68 m² ka pranuar e regjistruar me të meta e mangësi kontratat e shitblerjes trojeve nga Bashkia Kukës duke përdorur çmimi i referencës sipas VKM nr. 187, datë 06.03.2013 “Për Miratimin e Vlerës së Pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë” dhe konkretisht për ZK nr. 2315 Kukës është 10470 lekë/m², ndërsa çmimet e përdorura nga ana e Bashkisë, sipas pasqyrës të sipërcituar “çmimi i aplikuar” janë çmime pa referencë ligjore, pasi kontratat në disa raste janë bërë në vitin 2006, pasuri të pa regjistruara në emër të Bashkisë dhe në emër të qytetarëve përfitues. Ndërsa për efekt regjistrimi të këtyre kontratave është proceduar me anë të një deklaratë noteriale, mbajtur në vitin 2014 me objekt: për konfirmimin e kontratave të shitblerjes së pasurive, ku pala e bashkisë ligjëron shitjet e kryera në vitin 2006, veprim ky në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pasi për kontratat e vitit 2006 të pa regjistruara nuk janë aplikuar gjopa për regjistrim me vonesë mbi 30 ditë të kontratës së shitblerjes, duke u llogaritur për 4 raste x 300,000 lekë gjopa për çdo rast e barabartë me 1,200,000 lekë; veprim që ka sjellë pasojë vlerën **prej 28,229,939 lekë të ardhura të munguara për Bashkinë Kukës**, pasqyruar tabelën “Pasqyra e pasurive të regjistruara me kontratë shitje nga bashkia Kukës, në ZK 2315 Kukës.” (*Trajtuar hollësisht në faqet 102-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 33: ZVRPP Kukës dhe ZQRPP Tiranë të analizojnë rastet e të marrin masat lidhur me faktin që për periudhën janar - dhjetor 2014, rezultoi se në 23 praktika të audituara në **18 raste** me sipërfaqe 4671,68 m² ka pranuar e regjistruar me të meta e mangësi kontratat e shitblerjes trojeve nga Bashkia Kukës duke përdorur çmimi i referencës sipas VKM nr. 187, datë 06.03.2013 “Për Miratimin e Vlerës së Pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë” dhe konkretisht për ZK nr. 2315 Kukës është 10470 lekë/m², ndërsa çmimet e përdorura nga ana e Bashkisë, sipas pasqyrës të sipërcituar “çmimi i aplikuar” janë çmime pa referencë ligjore, pasi kontratat në disa raste janë bërë në vitin 2006, pasuri të pa regjistruara në emër të Bashkisë dhe në emër të qytetarëve

përfitues. Ndërsa për efekt regjistrim të këtyre kontratave është proceduar me anë të një deklarate noteriale, mbajtur në vitin 2014 me objekt: për konfirmimin e kontratave të shitblerjes së pasurive, ku pala e bashkisë ligjëron shitjet e kryera në vitin 2006, veprim ky në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pasi për kontratat e vitit 2006 të pa regjistruara nuk janë aplikuar gjopa për regjistrim me vonesë mbi 30 ditë të kontratës së shitblerjes, duke u llogaritur për 4 raste x 300,000 lekë gjopa për çdo rast e barabartë me 1,200,000 lekë; veprim që ka sjellë pasoje vlerën **prej 28,229,939 lekë të ardhura të munguara për Bashkinë Kukës**, pasqyruar tabelën “Pasqyra e pasurive të regjistruara me kontratë shitje nga bashkia Kukës, në ZK 2315 Kukës.”

Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 40/120, volum 28, faqe 189; nr. 23/108, volum 28, faqe 28; nr. 35/233, volum 28, faqe 195; 34/165, volum 28, faqe 74; nr. 28/142, volum 29, faqe 76; nr. 26/92, volum 29, faqe 62; nr. 26/124, volum 28, faqe 202; nr. 26/125, volum 28, faqe 203; nr. 34/170, volum 28, faqe 211; nr. 22/142, volum 28, faqe 57; nr. 28/149, volum 28, faqe 107; nr. 28/151, volum 28, faqe 131; nr. 21/71, volum 28, faqe 136; nr. 49/137, volum 28, faqe 130; nr. 34/17, volum 28, faqe 134; nr. 41/39, volum 28, faqe 146; nr. 40/123, volum 28, faqe 205; nr. 34/174, volum 28, faqe 233, ZK nr. 2315, Kukës, deri në dhënie konkluzioni nga ZQRPP Tiranë në lidhje mbi sa është konkluduar nga KLSH.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 28: Në ZVRPP Kukës nga auditimi në lidhje me shpronësimet për ndërtimin e segmentit rrugor “Kalimash-Morinë” doli se nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), me shkresë nr. 8862, datë 10.12.2014, për konfirmimin e gjendjes juridike të pasurive dhe kalimin në pronësi shtet të 593 pasurive, bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme prone private për interes publik”, ka kërkuar konfirmim për legjitimitetin e pasurive në emrin e pronarëve, numrin e pasurive, ZK, llojin e pasurisë dhe sipërfaqen dhe konkretisht: për ZK nr. 2724 Morinë janë kërkuar 123 pasuri; ZK nr. 1115 Bardhoc 2, janë kërkuar 92 pasuri; për ZK nr. 1114 Bardhoc 1, janë kërkuar 58 pasuri, për ZK nr. 1726 fshati Gjegjan, janë kërkuar 63 pasuri; për ZK nr. 2912, fshati Përbreg, janë kërkuar 40 pasuri; për ZK nr. 1176 fshati Breg Lume, janë kërkuar 42 pasuri; për ZK nr. 3425 fshati Shtiçen 107 pasuri; për ZK nr. 1543, fshati Drinas 62 pauri, për ZK nr. 2208, fshati Kolsh, për 4 pasuri, etj. Në lidhje mbi sa më lart nga ZVRPP Kukës me shkresë nr. 3357/3, datë 04.02.2015 i është dërguar konfirmim mbi gjendjen juridike të pasurive në zonat kadastrale si më poshtë: ZK nr. 2724 Morinë nuk janë bërë konfirmimet e kërkuara për 123 pasuri; ZK nr. 1115 Bardhoc 2, nuk janë bërë konfirmimet e kërkuara për 92 pasuri; për ZK nr. 1114 Bardhoc 1, nuk janë bërë konfirmimet e kërkuara për 58 pasuri, për ZK nr. 1726 fshati Gjegjan, nuk janë dërguar konfirmimet e kërkuara për 63 pasuri; ndërsa për ZK nr. 2912, fshati Përbreg, janë konfirmuar 29 pasuri, pra për 11 pasuri nuk ka dalë informacion, për ZK nr. 1176 fshati Breg Lume, janë kërkuar 42 pasuri, nga të cilat për 14 pasuri nuk ka informacion; për ZK nr. 3425 fshati Shtiçen nuk ka të dhëna për rreth 64 pasuri, me përshkrimin nuk figurojnë të regjistruara në këtë zonë kadastrale; për ZK nr. 1543, fshati Drinas nuk ka të dhëna për rreth 44 pasuri dhe për ZK nr. 2208, fshati Kolsh, për 4 pasuri.

Nga ana e ARRSH pas marrjes së përgjigjes konfirmuese të ZVRPP Kukës me shkresë nr. 3357/3, datë 04.02.2015 mbi konfirmimin e gjendjen juridike të pasurive, nuk ka asnjë informacion për ecurinë e procesit të shpronësimit dhe sidomos të regjistrimit të 135 pasurive me sipërfaqe 794.513.3 m² nga pasuri private në pasuri shtet me administrim ARRSH dhe të 15 pasurive me sipërfaqe 471.355 m² nga pronë e Institucioneve Shtetërore dhe Njësive të Qeverisjes Vendore në pronësi të ARRSH-së.

Nga ARRSH për segmentin Kalimash Morinë, në territorin që kalon nuk ka përcaktuar në hartë gjurma e kalimit të rrugës dhe sipërfaqet që do të shpronësohen, pasi në mjaft raste përshkruhet pronar i pa identifikuar, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”, për veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi specialistët e ZVRPP Kukës, për mos evidentim të plotë të pasurive të paluajtshme që do të shpronësohen*(Trajtuar hollësisht në faqet 131-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 34: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, dhe në bashkëpunim me ARRSH të hartojnë listat përfundimtare mbi konfirmimin e gjendjen juridike të pasurive të segmentit të rrugës Kalimash-Morinë, të bëhet propozimin për vendimin e KM si dhe të kryhet shpërblimi përfundimtar i pronarëve si dhe të inventarizojë sipërfaqen e rrugës dhe regjistrimin në pasuri shtet.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 29: ZVRPP Kukës në **18 raste**, ka regjistruar leje legalizimi në ZK nr. 2315, qyteti Kukës duke mos verifikuar elementët e përmbajtjes së Aktit Administrativ dhe VKM, mbi bazën e të cilëve janë miratuar parcelat ndërtimore dhe ndërtimet informale dhe konkretisht:

Të gjitha referencat e audituara doli se duhej të ishin refuzuar për sigurimin e dokumentacionit të trajtuar me mungesë si: harta e përditësimit, sipas kufizimeve të parcelës ndërtimore nuk ka rrugë hyrje në objekt, shkresa e Drejtorisë ALUIZNI-t Kukës, ortofoto dixhitale e fotografimit ajror; etj trajtuar rast pas rasti, veprime në papajtueshmëri me pikën 5 neni 44 e neni 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin e Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009, Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar sipas ligjit nr. 9482, dalë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” *(Trajtuar hollësisht në faqet 142-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 35: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 2315 për pasuritë nr. 22/145, volum 29, faqe 224; nr. 16/81ND, volum 19, faqe 28; nr. 16/75, volum 17, faqe 62; nr. 19/176, volum 27, faqe 92; nr. 46/143, volum 28, faqe 225; nr. 48/17, volum 27, faqe 60; nr. 50/242, volum 23, faqe 102; nr. 51/265, volum 29, faqe 88; nr. 51/119, volum 22, faqe 133; nr. 23/12, volum 29, faqe 73; nr. 40/120, volum 28, faqe 189; nr. 40/123, volum 28, faqe 205; nr. 48/97, volum 29, faqe 86; nr. 28/142, volum 29, faqe 140; nr. 35/169, volum 18, faqe 189; nr. 18/65, volum 29, faqe 113; nr. 34/149+1-2, volum 23, faqe 178 dhe nr. 50/199, volum 29, faqe 139, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 30: Nga veprimet e kryera në ZVRPP Kukës rezulton se sipërfaqet e pasurive të përcjella për regjistrim me shkresën nr. 650, datë 15.05.2014, sipas VKM 1691, datë 10.10.2007 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Prefektët e Administratën e tyre, Nënprefektët dhe administratën e tyre dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtorisë së PMNZSH-së)*”, nuk rakordojnë me ato të përcaktuara në listën e inventarit sipas sipërfaqeve dhe numrit të pasurive. Sipërfaqet e përcjella për regjistrim janë më të vogla përkatësisht kati përdhe 311.2 m² ndërkohë sipas listës 335.2 m², Kati II--261,80 m² sipas regjistrimit, ndërkohë sipas listës Kati përdhe, Kati I, dhe Kati II 504.3 m². Gjithashtu në kartelat e pasurive nuk është bërë emërtimit i objekteve sipas listës së inventarit*(Trajtuar më hollësisht në faqe (Trajtuar më hollësisht në faqe 100-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Rekomandim 36 : ZVRPP Kukës në çdo rast të regjistrimit të pasurive të transferuara në administrim dhe në pronësi të institucioneve të pushtetit vendor të kërkoj saktësimin e sipërfaqeve të pasurive të kaluara në administrimin sipas VKM-ve përkatëse, emërtimin e tyre në përputhje me

listën e inventarit, si dhe të plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm ligjor për regjistrimin e tyre në zbatim të kërkesave të Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje: Nga auditimi rezultoi se listat e trojeve të përcjella për regjistrim për zonat kadastrale 1277/Brekije dhe zk. 2684/Mhole janë të pa firmosura dhe vulosura nga Kryeplaku dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për zonat kadastrale zk. 2858/Pakisht dhe 2231/ Kosharisht listat janë të firmosura dhe vulosura vetëm nga Kryeplaku dhe jo nga Kryetari i Komunës. Regjistrimi i pasurive me dokumentacion jo të rregullt që nuk përmbush të gjithë elementët e formës dhe përmbajtjes të një dokumenti ligjor vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”(Trajtuar më hollësisht në faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 37: Nga ZVRPP Kukës të merren masa që në çdo rast për kryerjen e regjistrimeve sipas listave të trojeve të kontrollohet nëse dokumentacioni i përcjellë për regjistrim, përmbush të gjithë elementët e formës dhe përmbajtjes të një dokumenti ligjor në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 31: Nga auditimi rezultoi se bllokimet e pasurive nga Prokuroria apo Përmbarimi para viteve 2010 si në volumet e zonave kadastrale Mhole zk. 2684, Novosej zk. 2812 dhe Shishtavec zk. 3379, janë vendosur me copa letrash dorëshkrime pa u regjistruar në seksionin D të kartelave të pasurive në kundërshtim me Udhëzimin metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme (Trajtuar më hollësisht në faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 38: Nga ZVRPP Kukës të merren masa që në çdo rast të regjistrimit të bllokimeve për pasuritë të bëhen shënimet përkatëse në seksionin D të kartelave të pasurive të paluajtshme në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimit metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 32: Nga verifikimi i regjistrimeve të kryera sipas listës 001 “Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive”, në ZK-2684/Mhole, rezultoi se në 7 raste personat kishin marrë më shumë se një pasuri më listë trojesh, kjo pa u shoqëruar me dokumentacion tjetër justifikues për sipërfaqen tepër prej 1695 m², në ZK-3379/Shishtavec, në 15 raste për sipërfaqen tepër prej 7480 m², në ZK. 1045/Arrëz në 6 raste për sipërfaqen tepër 558 m² si dhe për ZK. 2812/Novosej, në 63 raste për sipërfaqen tepër prej 29290 m², në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978, dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (Trajtuar më hollësisht në faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 39: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës të merren masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e personave të cilët kanë përfituar më shumë se një pronë nga lista e trojeve, për ZK-2684/Mhole si vijon: 1- H. Q.R. Pas. 8/5, vol 1, fq. 13, zk.

2684 dhe Pas. 8/6, vol 1, fq. 14, zk. 2684; **2-** R. T.R. Pas. 4/2, vol 1, fq. 2 dhe Pas. 4/3, vol. 1, fq. 3; **3-** O. Y. R. Pas. 22/3, vol. 1, fq. 32 dhe Pas. 23/2, vol. 1, fq. 38; **4-** S. F.R. Pas. 25/1, vol. 1, fq. 41 dhe Pas. 31/1, vol 1, fq. 48; **5-** S. C. R. Pas.103/1, vol. 1, fq. 131 dhe Pas. 103/2, vol 1, fq. 132; **6-** P. G. H. Pas. 97/2, vol. 1, fq. 124 dhe Pas. 97/3, vol. 1, fq. 125; **7-** S. J. H. Pas. 118/2, vol. 1, fq. 150 dhe Pas. 118/3, vol 1, fq. 151, për **ZK-3379 /Shishtavec** si vijon: **1-**M. J. H. Pas. 55/40, vol 8, fq. 22 dhe Pas. 55/41, vol. 8, fq. 23; **2-** B. M. H. Pas. 55/43, vol 8, fq. 25, Pas. 55/45, vol. 8, fq. 27 dhe Pas. 55/62, vol. 8, fq. 43; **3-** R. J. K.i Pas. 55/162, vol 8, fq. 141 dhe pas. 55/163, vol. 8, fq. 143; **4-** I. Sh. B. pas. 55/168, vol 8, fq. 147 dhe pas. 55/171, vol. 8, fq. 150; **5-** B. H.B. pas. 55/187, vol 8, fq. 163 dhe pas. 55/186, vol. 8, fq. 165; **6-** N.Sh. J. pas. 55/185, vol 8, fq. 164 dhe pas. 55/184, vol. 8, fq. 166; **7-** P. K. B. pas. 55/189, vol 8, fq. 168 dhe pas. 55/190, vol. 8, fq. 169; **8-** Z. M. H. pas. 55/238, vol 8, fq. 216 dhe pas. 55/239, vol. 8, fq. 217; **9-** T. N. H. pas. 55/259, vol 8, fq. 236, pas. 55/260, vol. 8, fq. 237 dhe pas. 55/261, vol. 8, fq. 238; **10-** J.S. H.pas. 55/329, vol 9, fq. 53, pas. 55/330, vol. 9, fq. 54 dhe pas. 55/339, vol. 9, fq. 55; **11-** I. R.A. pas. 55/332, vol 9, fq. 57 dhe pas. 55/333, vol. 9, fq. 58; **12-** B.S.B. pas. 55/367, vol 9, fq. 85, pas. 55/368, vol. 9, fq. 86 dhe pas. 55/369, vol. 9, fq. 87; **13-** S. (S.)H, S, pas. 55/388, vol 9, fq.106, pas. 55/389, vol. 9, fq. 107 dhe pas. 55/390, vol. 9, fq. 108; **14-** F, E, D, pas. 55/480, vol----, fq.---- dhe pas. 55/481, vol. 9, fq. 181; **15-** T,N.B. pas. 41/14, vol--, fq.-- dhe pas. 55/2, vol. --, fq. --(*të pavidentifikuara*); për **ZK. 2812/Novosej**, për pasuritë për 63 persona të cilët kanë më shumë se një pronë sipas pasqyrës nr. 4“*Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 2812 Novosej Rrethi Kukës*”, në **ZK. 1045/Arrëz** për pasuritë për 6 persona të cilët kanë më shumë se një pronë sipas pasqyrës nr. 7“*Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 1045/Arrëz Rrethi Kukës*”, deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, deri në shfuqizimin certifikatave të lëshuara dhe veçimin e regjistrimit shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprim.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 33: Nga verifikimi i listave të trojeve të përcjella për regjistrim për 21 zona kadastrale, sipas tabelës nr. 1, emërtuar “*Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara/Tabela Përmbledhëse*”, rezultoi se në 1494 raste personat kanë përfituar mbi normë, pra më shumë se 300 m2, në total sipërfaqen prej 279447 m2, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978, dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, trajtuar më hollësisht sipas tabelës nr. 1, emërtuar “*Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara/Tabela Përmbledhëse*” (Trajtuar më hollësisht në faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi për veprimet e kryera në KPP rezultoi se në zk. 3379/Shishtavec në 12 raste, zk. 2812/Novosej në 9 raste dhe z.k 2684/Mhole në 5 raste janë kryer veprime dhe transaksione me pasuritë si lëshim certifikatë pronësie, regjistrim dëshmi trashëgimie apo regjistrim kontratë shitje, pa verifikuar gjendjen e pasurive dhe pa veçuar më parë në shtet sipërfaqen tepër prej 3715 m2 në total, ndërsa në 362 raste në total për të tre zonat kadastrale më sipër në të cilat nuk janë kryer veprime në KPP, nuk është veçuar në shtet sipërfaqja totale prej 88172 m2, trajtuar më hollësisht në pasqyrat nr. 4, emërtuar “*Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 2812 Novosej Rrethi Kukës*”, nr. 5, emërtuar “*Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3379/Shishtavec, Rrethi Kukës*” dhe nr. 2, emërtuar “*Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 2684 Fshati Mhole Rrethi Kukës*” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar.

Rekomandim 40: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74, për 23 pasuri pajisur me certifikatë pronësie apo lëshuar dëshmi trashëgimie dhe

për 362 pasuri me 13210 m² tepër pa veprime në KPP, deri në verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, deri në shfuqizimin certifikatave të lëshuara dhe veçimin e regjistrimit shtet të sipërfaqeve tepër në KPP pa veprime, trajtuar më hollësisht në pasqyrat nr. 4, emërtuar “Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 2812 Novosej Rrethi Kukës”, nr. 5, emërtuar “Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 3379/Shishtavec, Rrethi Kukës” dhe nr. 2, emërtuar “Pasuri me sipërfaqe trojesh mbi normë sipas Listave 001 të Hartuara, për ZK 2684 Fshati Mhole Rrethi Kukës” bashkangjitur Raportit Përfundimtar.

Brenda muajit Nëntor 2016

Rekomandim 41: Nga ZVRPP Kukës të merren masa për verifikimin dhe saktësimin në bashkëpunim me Bashkinë Kukës të listave të kryefamiljarëve gjendje në vitin 1991, listave të trojeve për 21 zona kadastrale trajtuar më hollësisht në tabelën nr. 1, emërtuar “Fshatra dhe ZK me Sipërfaqe Trojesh mbi Normë sipas Listave 001 të Hartuara/Tabela Përmbledhëse” si dhe tabelat shoqëruese për çdo zonë kadastrale, në të cilat ka rezultuar një sipërfaqe prej 279447 m² mbi normë prej 300 m², pa u veçuar në shtet, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978, dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, në ato raste kur me pasuritë janë kryer transaksione, si lëshim certifikatë pronësie, regjistrim dëshmie trashëgimie të vendoset masa e kufizimit në përputhje në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” deri në shfuqizimin e certifikatave të përfituar me tituj të paligjshëm pronësie dhe veçimin shtet të sipërfaqes tepër, ndërsa në rastet për KPP pa veprime të veçohet sipërfaqja tepër mbi normë.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 34: Nga auditimi për regjistrimin e pasurive sipas listave të trojeve 001 në zonën kadastrale 2812 /Novosej, rezultoi se janë të pidentifikuara me emër objekti apo ndërtese 46 pasuri shtet me sipërfaqe totale trualli 22147 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 14292 m², sipas pasqyrës nr. 3, emërtuar “Pasuri shtet të pidentifikuara”, bashkangjitur Raportit Përfundimtarë dhe në zonën kadastrale 3379 /Shishtavec, rezultoi se janë të pidentifikuara me emër objekti apo ndërtese 3 pasuri shtet me sipërfaqe totale trualli 865 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 390 m², sipas pasqyrës nr. 6, emërtuar “Pasuri shtet të pidentifikuara”, bashkangjitur Raportit Përfundimtarë (Trajtuar më hollësisht në faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 42 : Nga ZVRPP Kukës të merren masa për identifikimin e 49 pasurive shtet, si dhe të pasurive të tjera objekte shtetërore të pidentifikuara deri më tani, duke bërë shënimet përkatëse në kartelat e pasurive në përputhje me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 35: Në 1 rast në zk. 3379/Shishtavec për pasurinë nr. 55/245, vol 8, fq. 204, dhe në 3 raste në zk. 2684/Mhole për pasuritë nr. 132/3, vol 1, fq. 160, nr. 123/4, vol 1, fq. 159 dhe nr. 80/1, vol 1, fq. 106, janë konstatuar mospërputhje me emrat e pronarëve të pasurive dhe të sipërfaqeve, ndërmjet atyre të përcaktuara në listën e trojeve 001 dhe atyre të hedhura në kartelat e pasurive, ndërkohë që në referencat përkatëse nuk ka asnjë dokumentacion që justifikon ndryshimin e emrit si dhe ndryshimin e sipërfaqes. Gjendur përballë këtyre mangësive nga ana e ZVRPP Kukës nuk duhet të procedohej me regjistrimin e pasurive deri në saktësimin e emrave të pronarëve që posedojnë këto pasuri si dhe sipërfaqeve truall dhe ndërtim, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr.

33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (Trajtuar më hollësisht në faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 43: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës të merren masa në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi deri në saktësimin e emrave të pronarëve të pasurive si dhe saktësimin e sipërfaqeve, për pasuritë si vijon - nr. 55/245, vol 8, fq. 204, zk. 3379/Shishtavec, - nr. 132/3, vol 1, fq. 160, zk. 2684/Mhole, - nr. 123/4, vol 1, fq. 159, zk. 2684/Mhole dhe - nr. 80/1, vol 1, fq. 106, zk. 2684/Mhole.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 36: Regjistrimi i vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 2181 Akti, Nr. 6635 Vendimi, datë 26.06.2012 me objekt padie kundërshtimin dhe anulimin e aktit administrativ, vendimit nr. 185, datë 16.03.2011, të AKKP-së për njohjen pronar dhe kthimin fizik për sipërfaqen e lirë prej 3685 m², pronë e trashëgimtarëve të A. Z., mbi pasurinë nr. 11/112, vol. 28, fq. 117, zk. 2315, me sip. 3598 m² truall, në pronësi shtet vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, Neni 45 si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, pika 3, germa “c” dhe “d”, pasi vetë objekti i padisë është kundërshtimi dhe anulimi i aktit administrativ, vendimi gjykatës nuk përbën titull pronësie por i drejtohet palës së paditur AKKP-së të dalë me një vendim të ri për njohjen dhe kthimin fizik të pronës. Gjithashtu vendimi i gjykatës në asnjë pjesë të tij nuk është shprehur për detyrimin e ZVRPP Kukës për regjistrimin e pasurisë, si dhe nga ana tjetër në dispozitivin e vendimit nuk ka të dhëna të plota për pasurinë objekt gjykimi, të cilat do të bënin të mundur identifikim e saj. Në dosje mungon procesverbali për marrjen në dorëzim të pasurisë, gen plani si dhe plan vendosja (Trajtuar më hollësisht në faqe 156-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 44: Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 11/112, vol. 28, fq. 117, zk. 2315, deri në marrjen e vendimit nga AKKP-ja për njohjen dhe kthimin fizik të pronës.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 37: Në 3 raste janë shfaqur mangësi në dokumentacionin e përdorur për regjistrimin e pasurive me leje legalizimi për pasuritë nr. 47/136, vol. 31, faqe 3, zk. 2315, nr. 57/185, vol. 29, faqe 172, zk. 2315 dhe nr. 39/36, vol. 12, fq. 161, zk. 2315, pasi mungon ortofoto dixhitale dhe HTR e përditësuar në kundërshtim me VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” pika 11.1 - Dorëzimi i dokumentacionit përkatës të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, në ZVRPP dhe Udhëzimin nr. 2532, datë 21.04.2009, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, date 03.04.2006; “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” (Trajtuar më hollësisht në faqe 138-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 45: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor mbi pasuritë si vijon - nr. 47/136, vol. 31, faqe 3, zk. 2315, - nr. 57/185, vol. 29, faqe 172, zk. 2315 dhe - nr. 39/36, vol. 12, fq. 161, zk. 2315.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 38: Veprimet në kartelën e pasurisë nr. 39/36, vol. 12, fq. 161, zk. 2315, për regjistrimin e lejes legalizimit nr. 94729, datë 16.02.2015 nuk janë të rregullta dhe nuk është zbatuar procedura në kundërshtim me Udhëzim metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, pasi fillimisht nga ana e ZVRPP duhet të mbyllet kartela mëmë për të cilën është prishur ndërtimi, dhe të hapej një karte e re vetëm për pasurinë truall të ngelur prej 205.7 m2, më pas duhet të hapej një karte e re për regjistrimin e objektit me leje legalizimi dhe më pas të bëhet bashkimi i pasurisë truall me pasurinë objekt legalizimi. Gjithashtu në dosje përveç deklaratës noteriale Nr. 592 Rep, NR. 165 Kol, datë 09.02.2015, ku shtetasi B. P. deklaron se ka shembur pasurinë e tij dhe e ka ndërtuar nga e para, nuk administrohet vendimi për prishjen e ndërtimit të vjetër lëshuar nga Bashkia Kukës (*Trajtuar më hollësisht në faqe 138-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Rekomandim 46: Nga ZVRPP Kukës të merren masa që në të gjitha rastet e ngjashme për regjistrimin e lejeve të legalizimit mbi pasuri truall në të cilat ka pasur ndërtime të vjetra, të zbatohet procedura duke kërkuar nga subjekti aplikues të dorëzohet dokumentacioni për prishjen e ndërtimit të vjetër si dhe të kryhen veprime të rregullta në KPP në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimit metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 39: Në një rast në regjistrimin e pasurisë nr. 47/136, vol. 31, faqe 3, zk. 2315, sipas lejes së legalizimit nr. 98285, datë 15.10.2015, për objektin godinë Banimi 1 Kat+Bodrum, me sip. 500 m2 parcelë ndërtimore, si dhe 181.3 m2 sip. ndërtimi, në dokumentacionin e përcjellë për regjistrimin nga ALUIZNI, kartela e pasurisë në seksionin “Përshkrimi i veçantë”, ka shënimin Pasuria: *Godinë banimi 2Kat + Bodrum, -Planimetria e katit bodrum sip. ndërtesë 152.41 m2, me funksion banimi; - Planimetria e katit përdhe me sip. ndërtimi 181.30 m2;- Planimetria e katit parë me sip. ndërtimi 181.30 m2*, pra ka mospërputhje me lejen e legalizimit. Pavarësisht gabimit në kartelën e pasurisë të përcjellë nga ALUIZNI, ZVRPP ka kryer regjistrimin bazuar në planimetrinë e kateve duke ju përmbajtur lejes së legalizimit (*Trajtuar më hollësisht në faqe 138-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 47: Nga ZVRPP Kukës të merren masa që në të gjitha rastet e gabimeve në dokumentacionin e përcjellë nga ALUIZNI, nuk duhet të procedohet me regjistrimin e pasurisë deri në saktësimin e plotë të dokumentacionit, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” dhe Udhëzimit nr. 2532, datë 21.04.2009, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006; ”Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 40: Në 3 raste janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e dorëzuar për regjistrimin e lejeve të ndërtimit për pasuritë nr. 26/106, vol. 27, fq. 121, zk. 2315-Kukës Qytet, nr. 35/47+1-9D, vol. 28, fq. 78, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet, si dhe rregullimin e marrëdhënieve me truallin veprime këto në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, neni 48, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV-Regjistrimi fillestarë i një pasurie të paluajtshme, pika 12, Udhëzim nr. 3, datë 03.10.2012, Kreu IV- Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja, pika 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 71- 82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 48: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 26/106, vol. 27, fq. 121, zk. 2315-Kukës Qytet, nr. 35/47+1-9D, vol. 28, fq. 78, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dokumentimin e marrëdhënies së truallit me objektin ndërtesë.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 41: Regjistrimi i lejes së ndërtimit nr. 162, datë 09.03.2006, për pasurinë nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet, për objektin lokal shërbimi, e cila është dhënë për sipërfaqen 26 m², ka krijuar mbivendosje me një pjesë të pasurisë nr. 33/13 pallat i vjetër, për sipërfaqen 4 m² (pjesa e trotuarit) për përdorim të përbashkët dhe në pronësi shtetërore. Gjithashtu dhe një pjesë e pasurisë nr. 33/45, vol. 17, fq. 139, me sip. truall 158.32 m² dhe ndërtim 141.24, regjistruar me leje ndërtimi, krijon mbivendosje me një pjesë të pasurisë nr. 33/13 pallat i vjetër, për sipërfaqen 4.92 m²(pjesa e trotuarit) për përdorim të përbashkët dhe në pronësi shtetërore. Sipërfaqja totale ndërtimit për dy pasuritë është 141.24+26= 167.24 m², ndërkohë që sipërfaqja e përbashkët truall është 158.32 m², pra më e vogël, e për pasojë sip. 8.92 m², shtrihet jashtë pasurisë truall. Kjo sipërfaqe prej 8.92 m² është përfituar pa titull pronësie. Vetë leja e ndërtimit është dhënë në kundërshtim me kondicionet urbanistike dhe pa u rregulluar marrëdhënia me truallin, veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 3, datë 03.10.2012, Kreu IV- Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja, pika 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6. (Trajtuar më hollësisht në faqe 71- 82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 49: Nga ZVRPP Kukës pasi të saktësohet sipërfaqja e ndërtimit e cila shtrihet jashtë kufirit të pasurisë truall 158.32 m², mbi pasurinë 33/13, duhet të bëhet shënim në KPP e pasurisë 33/45-ND, vol. 31, fq. 32, se një pjesë e kësaj pasurie me sip 4 m² shtrihet mbi pasurinë nr. 33/13-pallat (pjesa e trotuarit), si dhe të nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 33/45, vol. 17, fq. 139, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet deri në rregullimin e marrëdhënies pasurisë ndërtesë me truallin.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 42: Në një rast është bërë korrigjimi i gabimit material për pasurinë nr. 33/45, vol. 17, fq. 139, zk. 2315, duke korrigjuar sipërfaqen e truallit nga 158 m² në 158.32 m², ndërsa sip. e ndërtimit nga 102 m² në 85.24 m², shoqëruar me HTR e hartuar në datë 12.11.2008 si dhe plan rilevimit përgatitur datë 23.10.2008 për saktësim sipërfaqe, ku sip. Truall është 158.32 m², dhe ndërtim 85.24 m² ku nga kjo 80.32 m², ndërtesë brenda kufirit të pronës truall, ndërsa 4.92 m² ndërtesë mbi pas. 33/13 pallat(pjesë trotuarit). Nga ZVRPP Kukës nuk është zbatuar procedura pasi në dosje nuk administrohet njoftimi që i është bërë palëve të interesuara, individëve që zotërojnë pasuritë kufitare në lidhje me korrigjimin, veprime këto kundërshtim me Ligjin 7348, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 48, pika d (Trajtuar më hollësisht në faqe 71- 82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 50: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat që në çdo rast të korrigjimeve të gabimeve materiale për saktësimin e sipërfaqeve të cilat prekin drejtpërdrejt pasuritë kufitare të zbatohet procedura për njoftimin e palëve të interesuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 43: Në një rast për regjistrimin e lejes së ndërtimit për pasurinë 26/100, vol. 27, fq. 121, është konstatuar se veprimet në kartelat e pasurive nuk janë të rregullta pasi pa regjistruar më parë kontratën e shitjes së truallit Nr. 2858 Rep. Nr. 540/2 Kol, datë 17.12.2012, në të njëjtën kartelë pasurie me truallin është regjistruar dhe leja e ndërtimit sipas Ref. 12644, datë 11.02.2013, përcjellë për regjistrim me shkresën nr. 10, datë 04.01.2013, veprime këto në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 24 –Regjistrimi fillestar dhe neni 34-Bashkimet dhe Ndarjet si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Udhëzimin metodik nr. 76 prot, datë 13/09/1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”

- Gjithashtu është përdorur referenca për regjistrimin e lejes së ndërtimit për të regjistruar bashkë me të dhe kontratën e shitjes për truallin, duke ju shmangur pagesës së tarifës së regjistrimit për kontratën e shitjes në vlerë 7000 lekë e cila përbën dëm ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në faqe 71- 82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 51: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat që në të gjitha rastet e tjera të ngjashme të kryen veprime të rregullta në kartelat e pasurive për rregullimin e marrëdhënieve të pasurisë truall me pasurinë objekt ndërtimi, në përputhje me kërkesat e Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 24 –Regjistrimi fillestar dhe neni 34-Bashkimet dhe Ndarjet, Udhëzimit metodik nr. 76 prot, datë 13/09/1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, si dhe Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Brenda muajit Nëntor 2016

Rekomandimi 52: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 7000 lekë e ardhur nga shmangja e pagesës së tarifës së regjistrimit për kontratën e shitjes, gjithashtu të nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 26/100, vol. 27, fq. 121, zk. 2315-Kukës Qytet deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Nëntor 2016

Gjetje 44: Vendimi i Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 449 prot, datë 28.10.2015, në favor të R.G.C. për tjetërsimin me kundërshtëpërblim të pasurisë nr. 34/81, vol. 31, fq. 17, zk. 2315, me sipërfaqe 381.25 m², si “Oborr në përdorim”, vjen në kundërshtim me VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, pika 1- “Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurës së kalimit në pronësi të sipërfaqeve, kur në dokumentin e pronësisë është bërë shënimi “oborr në përdorim”, si dhe regjistrimi i këtyre pasurive në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme”, pasi pasuria nuk është e regjistruar, dhe nuk ka dokument pronësie ku të jetë bërë shënimi “Oborr në përdorim”, por përkundrazi kjo pasuri është e llojit truall. Gjithashtu në dosje nuk administrohet asnjë dokument i cili vërteton se pasuria truall prej 381.25 m² shtet është klasifikuar si oborr në përdorim që futet në kategorinë “Periudha deri në 16.08.1961 sipërfaqja tokë /truall është deri në 500 m², sipas referencave ligjore VKM nr. 185/1956, neni 4, dhe VKM nr. 11/1957, neni 1”, çka bie në kundërshtim me Aneksin nr. 1- “Masa e sipërfaqeve të ndërtimeve dhe oborreve në përdorim sipas periudhave” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 5-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Rekomandimi 53 : Regjistruesi i ZVRPP Kukës të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 34/81, vol. 31, fq. 17, zk. 2315, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor.

Brenda muajit Nëntor 2016

17. Gjetje: Nga auditimi me zgjedhje në zonë kadastrale 1333- Bushtricë, në volumet nr. 1 dhe 2, për regjistrimin e pasurive me AMTP, rezultoi se në 7 raste edhe pse sipërfaqja e përcaktuar në AMTP është më e madhe se ajo e përcaktuar në Librin e Ngastrave, me sipërfaqe totale 5420 m², janë kryer veprime në KPP si lëshim certifikate pronësie, pa bërë më parë bilancin e pasurive sipas listave Printim III me kryefamiljarë si dhe dorëzuar deklaratën noteriale për heqje dorë nga sipërfaqja e tepërt. Këto veprime bien në kundërshtim me sipërfaqet e përcaktuara nga listat Printim-III me kryefamiljarë, ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” si dhe sipas periudhave ligjin 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqe 53-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 54 : Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës të merren masa për të nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë - nr. 574/3, volum 1, faqe 186, z.k 1333/Bushtricë; - nr. 573/4, volum 1, faqe 185, z.k 1333/Bushtricë; - nr. 139/9, volum 1, faqe 42, z.k 1333/Bushtricë; - nr. 147/2, volum 1, faqe 55, z.k 1333/Bushtricë; - nr. 296/1, volum 1, faqe 74, z.k 1333/Bushtricë; - nr. 9/8, volum 1, faqe 106, z.k 1333/Bushtricë; - nr. 544/2, volum 2, faqe 12, z.k 1333/Bushtricë; - nr. 567/2, volum 2, faqe 13, z.k 1333/Bushtricë, deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe saktësimin e tyre sipas listave printim III me kryefamiljarë për sipërfaqen totale **5420 m²**. Gjithashtu për të gjitha praktikat ku sipërfaqja e përcaktuar në AMTP është më e madhe se ajo e përcaktuar në Librin e Ngastrave, pra matjeve faktike në terren, por që nuk janë kryer veprime në kartelat e pasurive, në momentin që do të aplikohet për lëshim certifikatë pronësie apo transaksione të tjera, duhet të kërkohet deklarata noteriale për heqje dorë nga sipërfaqja e tepërt.

Brenda muajit Nëntor 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbarimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **18,177,277 lekë**, si më poshtë:

Rekomandim 1: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTTP) (rekomanduar masa org. nr.4, më sipër), për masat e marra zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë 426,309 lekë shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për 7 pasuri me sipërfaqe tepër +1919 m² tokë arë vlerësuar me çmimin koorent të kontratave, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie z. 1328 Bushat” .

Brenda 15 Dhjetor 2016

Rekomandim 2: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.6, më sipër), për masat e marra *zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015* “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë 209,981 lekë shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për 4 pasuri me sipërfaqe tepër +3060 m² tokë arë vlerësuar me çmimin korent të kontratave, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie ZK 2039 Kalimash”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Rekomandim 3: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr. 9, më sipër), për masat e marra *zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015* “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë 120,885 lekë shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e sipërfaqes “shtet” pa titull pronësie për 9 pasuri me sipërfaqe tepër +4704 m² tokë arë vlerësuar me çmimin korent të kontratave, sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie zk 2724 Morinë”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Rekomandim 4: ZVRPP Kukës, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Kukës dhe Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) (rekomanduar masa org. nr.10, më sipër), për masat e marra *zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015* “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe të ndiqen hapat e duhur ligjor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerë 649,350 lekë shkaktuar buxhetit të shtetit nga shitja e pasurisë nr. 91/11 v.5 fq 235 zk. 2724 Morine me sip 781 m² tepër +481 m² sipërfaqes tepër “shtet” truall pa titull pronësie nga qytetari L.I. D. vlerësuar me çmimin korent të kontratës sipas tabelave “Referencat dhe pasuritë me sipërfaqe tepër mbi te cilat është regjistruar shitje pa titull pronësie zk 2724 Morinë”

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje 1: Në 3 raste ka rezultuar se me pasuritë 43/1, vol. 1, 54, zk 2684 dhe 57/2, vol. 1, fq. 74, zk, 2684, nr. 156/471, vol. 2, 167, zk 2812 të regjistruar fillimisht sipas listës së trojeve 001, me sipërfaqe mbi normën prej 300 m², pa u veçuar më parë në shtet sipërfaqja e tepërt prej 423 m², janë kryer transaksione duke shitur e tjetërsuar pasurinë shtet tek personat privatë me pasojë një dëm ekonomik në vlerë 180,462 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, sipas periudhave të shkeljeve me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978 “Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave” ku shprehet “...Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²...” (Trajtuar më hollësisht në faqe 40-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 5: Nga ana e ZVRPP Kukës të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 180,462 lekë për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 423 m², nga personat përgjegjës si më poshtë:

- z. **H. K.** me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën 123,169 lekë, për tjetërsimin e sipërfaqes prej 138 m²
- z. **R. K.**, me detyrë ish-Regjistruesi për vlerën 49,989 lekë, për tjetërsimin e sipërfaqes prej 313 m²
- z. **E. N.** me detyrë ish-Specialist për vlerën 7,307 lekë, për tjetërsimin e sipërfaqes prej 285 m².

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 2.: Në 3 raste nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit, për pasuritë nr. 26/106, vol. 27, fq. 121, zk. 2315-Kukës Qytet, nr. 35/47+1-9D, vol. 28, fq. 78, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet dhe për këtë arsye janë përdorur shkresat e Bashkisë Kukës për të përcjellë dokumentacionin për regjistrim, ndërkohë që afati i fundit për përcjelljen e dokumentacionit për regjistrim, ka qenë brenda 30 ditëve, nga data e realizimit të aktit. Mos aplikimi i kamat vonesës vjen në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim duke i shkaktuar buxhetit shtetit një dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara **në vlerë 900,000 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqe 71-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 6: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **900,000 lekë** e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit nr. 3, datë 12.11.2013, si dhe nxjerrjen e urdhrin të kufizimit në bazë të nenit 5.1, neni 49.1 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasurinë për pasuritë nr. 26/106, vol. 27, fq. 121, zk. 2315-Kukës Qytet, nr. 35/47+1-9D, vol. 28, fq. 78, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje 3.: Regjistrimi i lejes së ndërtimit nr. 162, datë 09.03.2006, për pasurinë nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet, për objektin lokal shërbimi, e cila është dhënë për sipërfaqen 26 m², ka krijuar mbivendosje me një pjesë të pasurisë nr. 33/13 pallat i vjetër, për sipërfaqen 4 m²(*pjesa e trotuarit*) për përdorim të përbashkët dhe në pronësi shtetërore. Gjithashtu dhe një pjesë e pasurisë nr. 33/45, vol. 17, fq. 139, me sip. truall 158.32 m² dhe ndërtim 141.24, regjistruar me leje ndërtimi, krijon mbivendosje me një pjesë të pasurisë nr. 33/13 pallat i vjetër, për sipërfaqen 4.92 m² (*pjesa e trotuarit*) për përdorim të përbashkët dhe në pronësi shtetërore. Sipërfaqja totale ndërtimit për dy pasuritë është 141.24+26= 167.24 m², ndërkohë që sipërfaqja e përbashkët truall është 158.32 m², pra më e vogël, e për pasojë sip. 8.92 m², shtrihet jashtë pasurisë truall. Kjo sipërfaqe prej 8.92 m² është përfituar pa titull pronësie. Referuar çmimit të truallit sipas VKM Nr. 1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha Bashkitë dhe disa Komuna”, çmimi për metër katror sipas vlerës së tregut për zonën qytet Kukës është 4500 lekë/m², e për pasojë **vlera reale e përfituar sipas çmimit të tregut është 40,140 lekë (8.92 m² x 4500 lekë/m²) e cila përbën dëmin ekonomik real.**

- Gjithashtu në dosje nuk administrohet mandat pagesa për taksën mbi vlerën e shitjes të pasurisë 33/45, vol. 17, fq. 139, e cila referuar kontratës nr. 1681. Rep, Nr. 108 Prot, datë 23.12.2004, çmimi i shitjes është 1,950,000 lekë x 0.3 % = **5850 lekë**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në faqe 71-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 7: Nga Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **45,990 lekë** e ardhur nga tjetërsimi i pasurisë shtet si dhe mos pagesa e taksës mbi vlerën shitjes, gjithashtu të nxjerrë urdhrin të kufizimit në bazë të nenit 5.1, neni 49.1 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 33/45, vol. 17, fq. 139, zk. 2315-Kukës Qytet dhe nr. 33/45-ND, vol. 31, fq. 31, zk. 2315-Kukës Qytet deri në likuidimin e vlerës.

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje : Nga ZVRPP Kukës në **2 raste**, për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme nuk është arkëtuar tarifa e përcaktuar për hapësirat e përbashkëta të paregjistruara në vlerën prej **177,500 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, veprim në papajtueshmëri me nenin 71, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM nr. 713, datë 20.10.2011 “Për caktimin e tarifave të shërbimit në ZVRPP”, të ndryshuar dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 3842, datë 08.04.2014 “Për dërgim buletini”, dhe në

kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “**Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa**”, pika 2 (Trajtuar hollësisht në faqet 82-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 8: ZVRPP Kukës të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit prej **177,500 lekë**, sipas pasqyrës 3 evidentuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi **për 2 raste** të subjekteve ndërtues “A” shpk dhe “A-K.” shpk..

Brenda muajit Shtator 2016

Gjetje : Nga ZVRPP Kukës në 4 raste, janë regjistruar **23778 m²** në pronësi të A.A. C. nga shpronësimi sipas referencave 019-0947, 050-0947, 053-0947,053-944 pa pasur AMTP e vlerësuar me 600 lekë m² sipas VKM nr. 95, date 20.02.2004 në vlerën prej **14,266,800 lekë**, duke i shkaktuar dëm ekonomik shtetit. (Trajtuar hollësisht në faqet 112-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 9: ZVRPP Kukës në 4 rastet sipas referencave **nr. 019-0947, 050-0947, 053-0947,053-944** më parë se të kërkohet arkëtimi i detyrimit prej **14,266,800 lekë** për pasuritë e regjistruara pa pasur AMTP të marrë masat e kufizimit deri në përcaktimin e statusit ligjor të pronësisë nga Bashkia Kukës në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, germa “ç”.

Brenda 15 Dhjetor 2016

Gjetje: ZVRPP Kukës për **4 raste**, të marrë masat për arkëtimin e **vlerës prej 1,200,000 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, për mos regjistrim të kontratave të shitjes të vitit 2006 në ZK nr. 2315 qyteti Kukës sipas:

- kontrata e shitblerjes nr. 778 rep dhe nr. 98/2 kol, datë 11.04.2006 me palë shitëse bashkia Kukës dhe blerësi F. B., pasuria nr. 40/120, regjistruar në volum 28, faqe 189;
- kontrata e shitblerjes nr. 443 rep dhe nr. 82, datë 19.04.2006 me palë shitëse bashkia Kukës dhe blerësit B. & V.Gj., pasuria nr. 23/108, regjistruar në volum 28, faqe 28;
- kontrata e shitblerjes nr. 525 rep dhe nr. 69/3 kol, datë 15.03.2006 me palë shitëse Bashkia Kukës dhe pala blerëse Sh.E., pasuria nr. 26/92, regjistruar në volum 29, faqe 62;
- kontrata e shitblerjes nr. 777 rep dhe nr. 97/1 kol, datë 11.04.2006 me palë shitëse Bashkia Kukës dhe K.B. palë blerës, pasuria nr. 40/123, regjistruar në volum 28, faqe 205, Meqenëse koha e lindjes së detyrimit është mbi 8 vjet, sipas nenit 39 **Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim i cili shpreh:** “Nëse një kërkesë për regjistrim, sipas nenit 38 të këtij ligji, paraqitet më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatëvonesë, e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300,000 lekë”, pasi për kontratat e vitit 2006 të pa regjistruara nuk janë aplikuar gjopa për regjistrim, llogaritet vlera 300,000 lekë për çdo rast, veprime në papajtueshmëri me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”(Trajtuar hollësisht në faqet 102-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 10: Regjistruesi i ZVRPP Kukës, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **1,200,000 lekë** përkatësisht: 300,000 lekë për pasurinë nr. 40/120, volum 28, faqe 189; shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 23/108, volum 28, faqe 28; shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 26/92, volum 29, faqe 62 dhe shumës 300,000 lekë për pasurinë nr. 40/123, volum 28, faqe 205, deri në pagesën e plotë të vlerave.

Brenda muajit Shtator 2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **ti kërkohet Kryeregjistruarit ZQRPP Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:**

A. Masa “Vërejtje”

1. Për z. D.K., me detyrë Regjistruar nga data 27.11.2013- në vazhdim, për shkeljet e trajtuara në akt-verifikimin nr. 3 dhe në procesverbalet nr. 6, datë 24.05.2016, nr. 7, nr. 8, datë 26.05.2016, nr. 9, datë 26.05.2016, nr. 10, datë 26.05.2016, nr. 16, datë 30.05.2016, nr. 17, datë 30.05.2016, nr. 19 datë 31.05.2016, nr. 21, datë 31.05.2016, nr. 22, datë 31.05.2016, nr. 23, datë 31.05.2016, *në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

B. Masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”.

2. Për z. S. O., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit nga data 26.02.2008-në vazhdim, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 2, 4, 5, nr. 6, datë 24.05.2016, nr. 7, nr. 8, datë 26.05.2016, nr. 9, datë 26.05.2016, nr. 10, datë 26.05.2016, nr. 14, datë 26.05.2016, nr. 15, datë 26.05.2016, nr. 16, datë 30.05.2016, nr. 17, datë 30.05.2016, nr. 19 datë 31.05.2016, nr. 21, datë 31.05.2016, nr. 22, datë 31.05.2016, nr. 23, datë 31.05.2016, nr. 25, datë 26.05.2016, nr. 26, datë 31.05.2016, *në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

C. Masa “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”.

3. Për znj. B. D., me detyrë Specialiste juriste nga data 09.04.2014–në vazhdim, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 2, nr. 6, datë 24.05.2016, nr. 8, datë 26.05.2016, nr. 13, datë 26.05.2016, *në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4. Për znj. S.T.(D.), me detyrë ish-Specialiste nga data 18.11.2010- në vazhdim, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 2, nr. 8, datë 26.05.2016, nr. 13, datë 26.05.2016, nr. 27, datë 31.05.2016, *në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

I. Për ish drejtuesit dhe ish punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga “vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, përkatësisht për:

1. Për z. F.Gj., me detyrë ish-Regjistruar nga data 29.03.2010-31.11.2013, për shkeljet trajtuar akt-verifikimin nr. 3, dhe në procesverbalet nr. 6, datë 24.05.2016, nr. 14, datë 26.05.2016, nr. 18 datë 30.05.2016, nr. 20 *në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2. Për z. R.K., me detyrë ish-Regjistruar nga data 16.12.1999-31.01.2001, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 6, datë 24.05.2016, *në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3. Për z. R. T., me detyrë ish-Regjistruer nga data 01.09.2000-31.01.2006, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 2, 3, 4, 5, nr. 12, datë 26.05.2016, nr. 13, datë 26.05.2016, nr. 27, datë 31.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. Për zj. M.K., me detyrë ish-Regjistruese, vitet 1998-1999, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 4, 5, nr. 26, datë 31.05.2016, nr. 27, datë 31.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Për z. A.T., me detyrë ish-Regjistruer nga data 16.02.2006-29.03.2010, për shkeljet trajtuar në akt-verifikimin nr. 3 dhe në procesverbalet nr. 13, datë 26.05.2016, nr. 16, datë 30.05.2016, nr. 20, nr. 10, datë 26.05.2016, nr. 11, datë 11.05.2016 dhe nr. 25, datë 31.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Për z. H.K. me detyrë ish-Specialist Hartograf nga viti 16.12.1999-31.04.2014, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 2, 3, 4, 5, nr. 6, datë 24.05.2016, nr. 9, datë 26.05.2016, nr. 10, datë 26.05.2016, nr. 14, datë 26.05.2016, nr. 15, datë 26.05.2016, nr. 16, datë 30.05.2016, nr. 18 datë 30.05.2016, nr. 20 nr. 21 datë 31.05.2016, nr. 22, datë 31.05.2016, nr. 23, datë 31.05.2016, nr. 26, datë 31.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7. Për z. E.D., me detyrë ish-Specialist nga 22.06.2006- 19.02.2014, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 2, 3, 4, 5, nr. 6, datë 24.05.2016, nr. 11, datë 11.05.2016, nr. 26, datë 31.05.2016, nr. 27, datë 31.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8. Për z. E. N., me detyrë ish-Specialist nga data 16.09.2003-30.08.2005, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 2, 3, 4, nr. 6, datë 24.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9. Për z. G. I., me detyrë ish-Specialist Hartograf nga data 18.01.2014-31.03.2016, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. **1, 2, 4, nr. 6, datë 24.05.2016, nr. 8, datë 25.05.2016, nr. 13, datë 26.05.2016, nr. 26, datë 31.05.2016**, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10. Për znj. Gj. S., me detyrë ish-Specialiste nga data 01.04.2001-31.12.2006, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 2, 3, 4, nr. 27, datë 31.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11. Për znj. G. K., me detyrë ish-Specialiste nga data 22.02.2006-18.11.2010, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, 3, 4, nr. 6, datë 24.05.2016, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12. Për z. A.B. me detyrë ish- specialist nga data 22.07.2006-31.01.2008, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 2, 3, 5, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13. Për znj. Z.P., me detyrë ish specialiste nga data 16.12.1999-15.03.2004, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 2, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

14. Për znj. L. Gj., me detyrë ish specialiste nga data 01.03.2003-18.11.2007, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 2, në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për punonjësit aktual dhe 14 punonjësit e larguar përcaktuar më sipër masat kërkohen:

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 datë 21.3.2012“Për regjistrimin e pasurive të

paluajtshme”, me pikën 1, të UKM nr. 1, datë 31.07.2007 “Për proceduarat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar e veprimeve të tjera, të pasurive të paluajtshme, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për ZVRPP Kukës.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.20012, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

- I. Ndaj:**
- 1. R.T.**, me detyrë ish-Regjistrues në ZVRPP Kukës
 - 2. H.K.**, me detyrë ish-hartograf në ZVRPP Kukës
 - 3. B.D.**, me detyrë Juriste në ZVRPP Kukës
 - 4. S.T.**, me detyrë Juriste në ZVRPP Kukës

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R